

# Mbikëqyrja Publike mbi prokurimet publike:

## Studime rastesh

Botimi i 1-rë



**Tender për shfrytëzuesit e  
Kuzhinave Popullore në Shkup:**  
Për 1.5 milion euro, ushqimi  
shpërndahet në rrugë dhe jo  
çdoherë në pajtim me atë që është  
përcaktuar në marrëveshje



**Tender i pafund:**  
Rekonstruktimi i objektit të  
mëhershëm të Komercijallna Banka  
me 51 aneks-marrëveshje dhe  
vlerë të zmadhuar për 32%



**Tender për angazhim  
të ekspertëve për  
korridorët 8 dhe 10-d:**  
NP për Rrugët Shtetërore,  
për 13 ekspertë do të paguajë  
sa për 92 punonjës



Botim elektronik:

# Mbikëqyrja Publike mbi prokurimet publike: Studime rastesh

Botimi i 1-rë

Botues:  
Qendra për Komunikime Qytetare

Lektoroi në maqedonisht:  
Tatiana B. Eftimoska

Përkthimi në shqip:  
Agon Ismaili

Përkthimi në anglisht:  
Magdalena Simionska

Dizajni:  
Relativ

Botuar:  
Shkup, mars 2026

ЦИП:

# Përmbajtja

Hyrje	4
-------	---

---

Me një tender prej 1.5 milion euro, ushqimi për qytetarët në rrezik social në Shkup në vend që në kuzhinat popullore, po shpërndahe në rrugë (Tenderi i Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë për prokurimin e shujtave të gatshme për shfrytëzuesit e kuzhinave popullore me numër	5
---	---

---

Rekonstruktimi i objektit të mëhershëm të Komercijallna Banka nuk ka mbarim: 51 aneks dhe një rritje prej 32% të vlerës së tenderit (Tender i Shërbimit për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë për rekonstruktimin e objektit të mëhershëm të Komercijallna Banka me numër	19
---	----

---

NP për Rrugët Shtetërore, për 13 ekspertë të angazhuar rishtazi për korridoret VIII dhe X-d do të paguajë në nivel vjetor sa për 92 punonjës (Tenderi i Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore për asistencë teknike për ndërtimin e akseve të autostradës në Korridorin VIII dhe Korridorin X-d me numër	28
--	----

---

# Hyrje

Korrupsioni në prokurimet publike në Maqedoninë e Veriut vazhdon të jetë një problem serioz sistemik që drejtpërdrejt e dëmton sundimin e ligjit, e dobëson besimin e qytetarëve në institucionet dhe çon në shpenzim joracional të fondeve publike dhe keqpërdorim të tyre. Pavarësisht angazhimeve të shumta deklarative për të luftuar korrupsionin, praktika institucionale ende nuk tregojnë përparim të mjaftueshëm sistematik dhe të vazhdueshëm në detektimin, përpunimin dhe sanksionimin e praktikave korruptive, veçanërisht në fushën e prokurimeve publike, e cila mbetet fusha më e lëndueshme sipas analizave kombëtare për parandalim të korrupsionit.

Gjatë viteve të fundit, në vend që vazhdimisht të forcohen mekanizmat kontrollues dhe parandalues, janë vërejtur procese që në mënyrë plotësuese i zvogëlojnë mundësitë për mbikëqyrje efektive dhe sanksionim të keqpërdorimeve në prokurimet publike. Implementimi i pamjaftueshëm i mekanizmave ligjorë ekzistues krijon një mjedis në të cilin korrupsioni mund të mbijetojë dhe të përhapet. Shqetësim të posaçëm paraqet fakti që, pavarësisht ekzistimit të disa organeve kompetente për parandalimin dhe sanksionimin e korrupsionit, praktika tregon se reagimet shpesh janë të ngadalta, selektive ose jo mjaftueshëm efektive për të siguruar sanksionimin të vërtetë të shkeljeve dhe për parandalimin efektiv të abuzimeve në të ardhmen. Rëndësia e kësaj çështjeje rrjedh nga fakti se prokurimet publike përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit shtetëror dhe aplikohen në të gjithë sektorët e konsumit publik, nga shëndetësia dhe arsimit deri te infrastruktura dhe energjetika.

Në kuadër të projektit “Mbikëqyrja Publike mbi Prokurimet Publike” analizohen raste konkrete të procedurave të tenderimit për të cilat dyshohet se mund të jenë zhvilluar në mënyrë të paligjshme, e në të cilat kujdesi për paratë publike nuk ka qenë parësor. Këto raste identifikohen përmes analizës mbi pretendimet dhe të dhënat e paraqitura në flamujt e kuq që i aplikon Byroja për Prokurime Publike, përmes hulumtimeve të bazuara në informacionet që janë në dispozicion për publikun, si dhe përmes konsultimeve me qytetarët. Prezantimi publik i këtyre rasteve ka për synim jo vetëm ta informojë publikun, por edhe të krijojë presion të shtuar mbi institucionet për të ndërmarrë hapa të përshtatshëm drejt sanksionimit të tenderëve të zhvilluar në mënyrë të paligjshme, si dhe zbatimin konsistent të dispozitave ligjore dhe vendosjes së standardeve më të larta për transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi.

Nëpërmjet rasteve specifike të tenderëve që do të publikohen në opinion dhe do t'u dërgohen institucioneve kompetente, synimi është që të kontribuohet në drejtim të kapërcimit të dobësive të vazhdueshme në reagimin institucional, proaktivitetit të pamjaftueshëm në detektimin e keqpërdorimeve dhe efikasitetit të kufizuar në zbatimin e procedurave ligjore në prokurimet publike. Në këtë mënyrë, do të kontribuohet në forcimin e rolit të shoqërisë qytetare, mediave dhe qytetarëve për të ushtruar mbikëqyrje aktive mbi shpenzimin e fondeve publike, me qëllim që të reduktohen mundësitë për ndikim politik, keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe për praktika korruptive në sektorin publik.

## Me një tender me vlerë prej 1.5 milion euro, ushqimi për qytetarët në rrezik social në Shkup në vend që të shpërndahet në kuzhinat popullore, po shpërndahet në rrugë

(Tenderi i Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë për prokurim të shujtave të gatshme për shfrytëzuesit e kuzhinave popullore me numër 13225/2025)



Përshkrimi i fotove: Ushqim i shpërndarë më 20.12.2025:  
100 gramë feta të prera pule, një copë qepë dhe bukë

- Marrëveshja për prokurimin publik nuk zbatohet në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit dhe ofertën, që është në kundërshtim me Ligjin për Prokurime Publike.
- Dokumentacioni i tenderit të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë nënkupton që ekzistojnë hapësira që shërbejnë si kuzhina popullore, mirëpo në praktikë, në 7 prej 9 lokacioneve të përmendura, ushqimi shpërndahet drejtpërsëdrejti në rrugë.
- Fakti që kuzhinat popullore praktikisht nuk funksionojnë, ndërsa në tenderët vazhdohet të përdoret formalisht ky term sikur ato ekzistojnë, flet për një fshehje institucionale të situatës reale dhe manipulim me elementet themelore të prokurimit publik.
- Të dhënat në dokumentacionin e tenderit kanë shërbyer si bazë për përcaktimin e çmimit për një shujtë, pra kushtet e paraqitura kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi realitetin dhe arsyeshmërinë e çmimit të rënë dakord.
- Shujtat, të cilat shteti i paguan nga 239 denarë janë me çmim konsiderueshëm më të lartë nga çmimet me pakicë të produkteve që janë të përfshira në këto paketa.
- Në vend të 2 orëve të paraqitura për shpërndarje dhe shërbim të ushqimit në secilin lokacion veçmas, furgonët për distribuim qëndrojnë prej 15 deri 30 minuta.
- Realizimi i marrëveshjes për prokurimin publik devijon nga kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar dhe në raport me menytë. Në disa ditë kanë munguar supa, pemët dhe djathi, ndërsa në disa raste të caktuara sasitë që janë livruar nuk kanë qenë në pajtim me marrëveshjen.
- Mosrespektimi i menyve javore, normave për orientim, kohës së dorëzimit dhe cilësisë së shujtave në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar konsiderohen shkelje të rënda të marrëveshjes dhe bazë për ndërprerjen e saj.
- Marrëveshja formalisht parasheh të sigurohet ushqim për 1,000 shfrytëzues, ndërsa vlera e saj financiare mbulon shujta për 1,027 persona. Krahasuar me vitin e kaluar, kjo sugjeron në një rritje të numrit të shfrytëzuesve për 26% - nga 813 në 1,027 persona. Megjithatë, të dhënat e sakta dhe zyrtare për numrin e shfrytëzuesve nuk janë të disponueshme, gjë që krijon hapësirë për dyshime dhe abuzime të mundshme.
- Ministria nuk e përmbush detyrimin ligjor për transparencë dhe llogaridhënie me faktin që nuk i dërgoi informacionet e kërkuara për procedurën e zhvilluar të tenderit dhe për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes. Qasja e këtillë e zvogëlon besimin e publikut në institucionet dhe çon drejt shpërfilljes së detyrimeve ligjore.
- Praktika e shpërndarjes së ushqimit në rrugë paraqet një trajtim të institucionalizuar poshtërues ndaj njerëzve në rrezik social, dhe me këtë, shteti në vend që të ofrojë mbrojtje, i ekspozon shfrytëzuesit ndaj stigmatizimit, degradimit dhe shkeljes së të drejtës së tyre themelore për dinjitet.
- Për nënshkrimin e kësaj marrëveshjes për prokurim publik, me vlerë prej afërsisht 1.5 milion euro, janë nevojitur shtatë muaj e gjysmë dhe tre procedura tenderimi në të cilat janë paraqitur gjashtë ankesa nga pjesëmarrësit.
- Motivet për betejën për tenderin mund të jenë në lidhje me çmimin. Për shujtën me meny dhe përbërjen që në Shkup kushton 239 denarë, Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale në Tetovë paguan 105 denarë, ndërsa shujtën e përgatit Kopshti për fëmijë “Mlladost” nga Tetova.
- Në periudhën midis skadimit të marrëveshjes së mëparshme për prokurim të shujtave të gatshme për shfrytëzuesit e kuzhinave popullore (17.05.2025) dhe nënshkrimit të marrëveshjes së re (24.09.2025) nuk ka të dhëna se mbi cilën bazë ligjore dhe nga cili operator ekonomik është siguruar ushqim për shfrytëzuesit e Kuzhinave popullore.

## Ushqimi nuk shërbehet në ambientet e paraqitura në dokumentacionin e tenderit

Tenderi me titull “Prokurimi i shujtave të gatshme për shfrytëzuesit e Kuzhinave popullore” me numër 13225/2025 është zbatuar nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe në bazë të saj, më 24 shtator 2025 është nënshkruar një marrëveshje për prokurim publik me vlerë prej 89,775,000 denarë, ose 1,459,756 euro.

Dokumentacioni i tenderit parashikonte që kompania, e cila do ta fitonte tenderin, të bëjë për përgatitjen, shpërndarjen dhe shërbimin e shujtave të gatshme për shfrytëzuesit e kuzhinave popullore në 9 lokacione të paraqitura për në territorin e qytetit Shkup. Me shujtë të gatshme nënkuptohet drekë e përgatitur paraprakisht, e dedikuar për t’u distribuar tek shfrytëzuesit përfundimtarë, e cila është e paketuar dhe e transportuar në mënyrë të përshtatshme në përputhje me standardet përkatëse për siguri ushqimore. Shfrytëzuesit fitojnë vetëm nga një vakt në ditë - drekën, e cila shpërndahet çdo ditë, nga e hëna deri të premten. Për të shtunën dhe të dielën, shujtat e ftohta, përkatësisht pakot e drekës, shpërndahen ditën e premte.

Por dokumentacioni i tenderit është një gjë, ndërsa realiteti është ndryshe.

Në terren, kuzhinat popullore nuk ekzistojnë më, as nuk kanë ekzistuar prej vitesh. Gjithashtu, në shumicën e lokacioneve të listuara në dokumentacionin e tenderit (bashkësitë lokale, ambientet e shoqatave të pensionistëve, qendrat për punë sociale) nuk janë krijuar kushtet për shërbimin dhe për konsumimin e ushqimit për shfrytëzuesit.

Foto të pamjes aktuale të Kuzhinave Popullore



Pasi që fillimisht u kuptua se tashmë vite me radhë nuk shpërndahet ushqim në lokacionet e paraqitura në dokumentacionin e tenderit, u bënë përpjekje që përmes Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe Qendrës Ndërkomunale për Punë Sociale të Qytetit të Shkupit t'i gjejmë informacionet për lokacionet e vërteta në të cilat bëhet shpërndarja e shujtave. Përpjekjet për të fituar këto informacione ishin të pasuksesshme dhe na është dhënë një shpjegim se lokacionet u komunikohen vetëm shfrytëzuesve të kuzhinave popullore. Me këtë përgjigje nga punonjësit e Qendrës Ndërkomunale për Punë Sociale të Qytetit të Shkupit, u krijua përshtypja që shpërndarja dhe shërbimi i shujtave kryhet në ambiente të mbyllura. Megjithatë, duke kërkuar në terren për vendet e treguara, erdhëm deri në gjetjet konkrete të paraqitura në këtë studim të rastit.

Sipas informacioneve të fituara në terren, ushqimi shpërndahet në 9 lokacione, 7 prej të cilave janë në rrugë, kurse vetëm 2 janë me ambiente të mbyllura, përkatësisht në barakën e Shoqatës së Pensionistëve në Butel dhe në ambientet e ish-Qendrës për Punë Sociale në Shuto Orizarë. Megjithatë, edhe në këto 2 lokacione, ambientet shërbejnë vetëm për dorëzimin e ushqimit nga furnizuesi dhe atë ushqim ta marrin shfrytëzuesit.



Përshkrimi i paraqitur në dokumentacionin e tenderit	Gjetjet nga terreni
<p><b>Komuna e Qendrës</b> – Në ambientet e Qendrës Mjekësore “Rade Jovčevski Korçagin”, rruga “Gjuro Gjonoviç” nr. 43, Shkup. Çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 12:00.</p>	<p>Ushqimi nuk shpërndahet në ambientet e listuara, por në 2 lokacione të ndryshme nga ato që janë të specifikuar në dokumentacionin e tenderit dhe në marrëveshjen, ndërkaq të cilat u gjetën dhe u vizituan më 10.11.2025 dhe 14.11.2025. Bëhet fjalë për lokacionet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në vend në të hapur, përpara një dyqani në rrugën Gjuro Gjonoviç. Në vend të kohës së paraqitur, furgoni mbërriti rreth orës 11:30 të paradites. Këtu, sipas informacioneve nga shfrytëzuesit, ushqim marrin 8 persona.</li> <li>Në vend në të hapur, në rrugën “Samoilova”, në afërsi të varrezave franceze. Në vend të kohës së paraqitur, furgoni mbërriti rreth orës 11:45 të paradites. Të pranishëm ishin rreth 30 persona, të cilët merrnin ushqim edhe për disa anëtarë të familjes.</li> </ul>

<p><b>Komuna e Çairit</b> – Shkolla Fillore “Imri Elezi” (ish-Shkolla Fillore Nikola Vapcarov) rruga “Braça Rexhepagiç” pn Shkup. Shpërndarja e shujtave të gatshme të kryhet çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 12:00.</p>	<p>Ushqimi shpërndahet pranë oborrin e kësaj shkolle, në vend të hapur. Vizita në këtë lokacion u zhvillua më datë 17.11.2025 dhe 19.11.2025. Në orën e paraqitur, më 17.11.2025 furgoni tashmë kishte shkuar nga lokacioni. Morëm informacion se furgoni mbërrin në orën 9:00. Më datë 19.11.2025, në këtë lokacion, në orën 9:00 kishte rreth 20 persona. Ata merrnin ushqim për disa persona, madje edhe për 14 persona.</p>
<p><b>Komuna e Butelit</b> – Në barakën e Shoqatës së Pensionistëve Butel, rruga “Butellska” pn (pranë komisariatit të policisë). Çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 12:00.</p>	<p>Ushqimi dorëzohet në ambientet e shoqatës së pensionistëve. Vizita në këtë lokacion u zhvillua më datë 14.11.2025, 17.11.2025 dhe 21.11.2025. Në këtë lokacion furgoni mbërriti rreth orës 9:30. Shfrytëzuesit e ushqimit informuan që sipas asaj që ata e dinë, në këtë lokacion ushqim u shpërndahet 30 personave.</p>
<p><b>Komuna e Kisella Vodës</b> – në ambientet e KL-së në lagjen Draçevë, rr. “Ratko Mitroviç” pn, Shkup - çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 12:00.</p>	<p>Ushqimi nuk shpërndahet në ambientet e specifikuara, por në parkun pas komunitetit lokal. Lokacioni u gjet dhe aty vizita u zhvillua më datën 14.11.2025 dhe 20.11.2025. Më 20.11.2025, furgoni ishte tashmë në vend dhe ushqimin ua shpërndanin afërsisht 15 personave. Disa nga shfrytëzuesit morën ushqim për më shumë se një person.</p>
<p><b>Komuna e Kisella Vodës</b> – në një ambient në lagjen Kisella Voda, rruga “Mihail Çakov” pn, çdo ditë pune nga ora 09:30 deri në 11:30.</p>	<p>Në lokacionin e paraqitur nuk mund të gjenim asnjë vend në të cilin shpërndahej ushqim për qytetarët në rrezik social, dhe as banorët lokalë nuk kishin ndonjë informacion të tillë.</p>
<p><b>Komuna e Shuto Orizarës</b> – Në një hapësirë në objektin e mëhershëm të QPS-së Shuto Orizari – rr. “Nov Zivot”, Shkup. Çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 12:00.</p>	<p>Vizita në lokacion u zhvillua më 25.11.2025. Furgoni solli ushqimin rreth orës 9:30 të mëngjesit dhe e la në ambientet e ish-Qendrës për Punë Sociale. Rreth 20 persona po prisnin përpara Qendrës. Përfituesit na informuan se po lihej ushqim për 120 persona.</p>
<p><b>Komuna e Gazi Babës</b> – në hapësirat e bashkësisë lokale Maxhari (ndërtesa e kinemasë së vjetër, rr, “Blagoj Stevkovski” pn, Shkup). Çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 12:00.</p>	<p>Vizita në lokacion më 28.11.2025 dhe 12.12.2025. Ushqimi nuk shpërndahet në ambientet e specifikuara, por në të hapur, përpara ndërtesës së kinemasë së vjetër. Furgoni mbërriti rreth orës 10:45 dhe ushqimi iu shpërnda 30 personave, të cilët morën disa shujta, disa madje edhe nga 7-8.</p>
<p><b>Komuna e Gazi Babës</b> – në ambientet e Shoqatës së Pensionistëve në Gazi Baba në barakën - Maxhari 2, rr. “Pallmiro Tolati” pn, Shkup. Çdo ditë pune nga ora 10:00 deri në 12:00.</p>	<p>Vizita në këtë lokacion u bë më datë 30.01.2026. Ushqimi u shpërnda për njerëzit në rrugën përpara ish-kuzhinës së të varfërve që u ndërtua për këtë qëllim vite më parë. Furgoni mbërriti rreth orës 10:45 dhe 10 persona morën ushqim, megjithatë secili prej tyre morën shujta për disa persona.</p>
<p><b>Komuna e Karposhit</b> – Në ambientet e Bashkësisë Lokale Zlokuqani. Çdo ditë pune nga ora 09:30 deri në orën 11:30.</p>	<p>Ushqimi nuk shpërndahet në vendin e paraqitur, por në vend të hapur pranë një servisi për vetura në rrugën “Skupi”. Lokacioni u gjet dhe vizita u zhvillua më 19.12.2025. Furgoni nuk mbërriti në kohën e paraqitur, por në orën 10:40. Në këtë lokacion ishin diku rreth 15 persona, gjysma e të cilëve fëmijë.</p>

Duke marrë parasysh dallimet e paraqitura në dokumentet e tenderit dhe marrëveshjen e nënshkruar kundrejt realizimit, në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik, prej Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë i kemi kërkuar informacionet si në vijim:

- » Përshkrim i përpiktë i të gjitha lokacioneve ku bëhet shpërndarja e ushqimit, veçmas për secilin lokacion;
- » A ka ndryshim të lokacioneve ku livroheshin shujtat e gatshme për shfrytëzuesit e Kuzhinave Popullore në raport me dokumentacionin e tenderit (nëse ka, ju lutemi t'i listoni ato)?; dhe
- » Të paraqitet numri i shfrytëzuesve në secilin lokacion për livrimin e lëndës së marrëveshjes së prokurimit publik?

Ministria nuk e përmbushi detyrimin ligjor dhe nuk i fituam informacionet e kërkuara, për çka më pas është parashtruar një ankesë në Agjencinë kompetente për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik. Megjithatë, për shkak të mungesës së personelit udhëheqës, përkatësisht drejtorit dhe zëvendësdrejtorit, Agjencia nuk vendos lidhur me ankesat e parashtruara.

Sipas nenit 116 paragrafi (2) të Ligjit për Prokurime Publike (LPP), marrëveshje për prokurime publike nënshkruhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit dhe ofertën. Në të njëjtën kohë, palët kontraktuese, në përputhje me nenin 117 paragrafi (1) të LPP-së, marrëveshjen për prokurimin publik e realizojnë në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit dhe ofertën që është përzgjedhur si më e favorshme. Duke marrë këtë parasysh, gjatë fazës së realizimit të marrëveshjes nuk lejohen ndryshime të kushteve, përkatësisht në këtë rast konkret, palët kontraktuese janë të detyruara që marrëveshjen ta zbatojnë në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit dhe ofertën që është përzgjedhur si më e favorshme.

Sipas nenit 117 paragrafi (2) të Ligjit për Prokurime Publike, autoriteti kontraktues është i detyruar të ushtrojë kontrolle nëse realizimi i marrëveshjes për prokurime publike ose marrëveshjes kornizë është në përputhje me kushtet e kontratës.

Gjithashtu, me ndryshimet që janë bërë e që nuk janë në përputhje me Ligjin për Prokurime Publike dhe me të cilat shpërndarja e ushqimit bëhet në rrugë, shkelet dinjiteti i personave në rrezik social dhe ata ekspozohen ndaj stigmatizimit. Njerëzit presin në radhë në parqe dhe rrugica, të ekspozuar ndaj shikimeve të tjerëve dhe në kushte të motit të keq. Në këtë mënyrë, në vend të mbështetjes sociale, ata fitojnë një ndjenjë poshtërimi. Në të njëjtën kohë, mungesa e informacionit të saktë për lokacionin dhe numrin e shfrytëzuesve e kufizon mbikëqyrjen publike mbi zbatimin e marrëveshjes, duke krijuar hapësirë për parregullsi të tjera.

Problemi tjetër i vërejtur gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje për prokurim publik është gjithsesi koha e shpërndarjes. Ndryshe nga 2 orët e deklaruara për shpërndarjen e ushqimit (gjë që do të ishte logjike nëse ushqimi do të shpërndahej dhe shërbehej në ambiente të mbyllura), në praktikë ushqimi shpërndahet mesatarisht në kohëzgjatje prej rreth 15 minutash. Shfrytëzuesit e pranishëm në lokacionet madje pohojnë që vijnë edhe më herët se ora e zakonshme e mbërritjes së furgonëve me qëllim që të mos e humbasin kohën kur bëhet shpërndarja dhe kështu ta humbasin të drejtën për të fituar ushqim.

## Ushqimi i shpërndarë në disa ditë devijon nga marrëveshja e rënë dakord

Në dokumentacionin e tenderit, kurse më pas edhe në marrëveshjen e nënshkruar për prokurim publik, janë listuar menytë javore (për 4 javë), normat orientuese për përgatitjen e një shujtë-drekë të gatshme dhe normat orientuese për një pako shujtë-drekë të ftohtë për gjatë fundjavës. Sipas marrëveshjes, orari i shujtave gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes mund të ndryshohet, por me pëlqim të ndërsjellë midis palëve kontraktuese. Gjatë monitorimit të zbatimit të kontratës, janë vërejtur ndryshime të shpeshta të menyve, por nuk ka informacion nëse kjo është bërë me miratimin e Ministrisë.

Konstatimi i dytë i rëndësishëm është se menytë e ofruara në ditë të caktuara, ndërsa veçanërisht në ditët e fundjavës, devijojnë nga përmbajtja dhe sasia e rënë dakord.

### Gjetjet në terren:

Komuna e Qendrës (në rrugën “Samoillova”, pranë varrezave franceze), më 14.11.2025 (e premte, java e dytë). Shfrytëzuesve të kuzhinës popullore u është dhënë biftek pule me oriz, sallatë dhe bukë. Sipas marrëveshjes, kjo është menya nga e mërkura, java e tretë e muajit dhe në menynë duhet të ketë supë pule, biftek pule me oriz të zier, sallatë dhe bukë. Në pakon e shpërndarë mungon supa. Shfrytëzuesit e këtyre shujtave thanë se jo vetëm atë ditë, por që supë nuk u është dhënë asnjëherë.



**Komuna e Butelit** (në barakën e Shoqatës së Pensionistëve Butel, rr. “Butellska” pn), më datë 17.11.2025 (e hënë, java e tretë e muajit) shfrytëzuesve të kuzhinës popullore u është dhënë një racion thjerrëza të ziera, një vezë e zier dhe bukë. Sipas marrëveshjes, kjo është paraparë në menynë nga e hëna, javën e katërt. Në këtë meny, sipas marrëveshjes përfshihen thjerrëza të ziera, vezë të ziera, sallatë sezonale, fruta sezonale, bukë. **Rezultoni se shfrytëzuesve të kuzhinës popullore nuk u janë dhënë sallatë sezonale dhe fruta sezonale.**



**Komuna e Gazi Babës** (përballë ndërtesës së kinemasë së vjetër, rr. “Blagoj Stevkovski” pn, Shkup) më datë 28.11.2025 (e premte, java e katërt) shfrytëzuesit e kuzhinës popullore morën oriz me kofshë pule, sallatë lakre dhe bukë. Sipas marrëveshjes, kjo është meny nga e mërkura, java e parë, sipas së cilës shfrytëzuesit e kuzhinës popullore duhet të marrin një supë pule, oriz me kofshë pule, sallatë sezonale dhe bukë. Në menynë e shpërndarë mungon supa e pulës. Gjithashtu, shfrytëzuesit e këtyre shujtave thanë se jo vetëm atë ditë, por që supë nuk u është dhënë asnjëherë.

Meqenëse ishte e premte, këtë ditë shfrytëzuesve u janë dorëzuar edhe pakot e drekës për ditët e fundjavës, pra të shtunën dhe të dielën. Për të dyja ditët, për një person janë dorëzuar salcë kosi me 12% yndyrë, 2 vezë të ziera, 75 gramë pashtetë, 2 tranguj turshi dhe 2 kulaçë.

**Ushqimi për të shtunën dhe të dielën për 1 person**



Sipas marrëveshjes, produktet e shpërndara janë menytë e ditës së shtunë dhe të diel të javës së parë të muajit. Të shtunën duhej të ishin shpërndarë salcë kosi, dy vezë të ziera, fruta sezonale dhe bukë. **Në pakon e dorëzuar mungojnë frutat sezonale, ndërkaq njëkohësisht, salca e kosit është me përmbajtje prej 12% yndyrë, megjithëse në marrëveshjen thuhet salcë kosi me përmbajtje prej 18% yndyrë.**

Menyja javore përbëhet nga një pashtetë pule prej 75 gr., djathë, tranguj turshi dhe bukë. **Në këtë meny nuk është siguruar dhe dorëzuar djathi i paraparë.**



**Komuna e Karposhit** (Zlokuqani, përballë servisit përvetura, në rrugën “Skupi”) për datën 19.12.2025 (e premte, e diela e tretë e muajit). Shfrytëzuesit e kuzhinës popullore për të premtën morën makarona të grira dhe bukë. Sipas marrëveshjes, bëhet fjalë për menyë për ditën e enjte të javës së katërt, kur duhet të shpërndahen makarona të grira, kos, biskotë dhe bukë. Në pakon e dorëzuar mungojnë kosi dhe biskota.

Në Zlokuqani, në të njëjtën ditë është shpërndarë ushqimi edhe për ditën e shtunë dhe për të dielën. Për ditën e shtunë u kanë shpërndarë 100 gramë mish pule të prerë në feta, një copë qepë dhe bukë. Sipas marrëveshjes, kjo është një menya për të shtunën që duhet të përfshijë kafjall me mish, perime sezonale, simite dhe bukë. **Rezulton se në pakon e dorëzuar me ushqim mungon një simit, kurse qepa është konsideruar si sallatë sezonale.** Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet se në përshkrimin e sasive në marrëveshjen e nënshkruar thuhet 100 deri 150 gramë mish të prerë në feta. Ky është një dallim i madh në sasi dhe lëshim që i ka ndodhur autoritetit kontraktues sepse, është diçka e pritshme që kompania të dorëzojë sasinë më të ulët, ndërsa dallimi është 50% në sasi.



Për ditën e diel janë shpërndarë djathë, bukë dhe ëmbëlsirë. Sipas marrëveshjes, kjo është menya për të dielën, javën e katërt, dhe në duhet të jenë të përfshira 2 vezë të ziera, djathë, ëmbëlsirë dhe bukë. **Në këtë shujtë mungonin 2 vezë.**



Komuna e Gazi Babës, në lokacionin e dytë, përballë ish-kuzhinës popullore, më datën 12.12.2025 bëhej shpërndarje e shujtës që përfshin gulash me mish viçi dhe një pjatë anësore me oriz të zier, sallatë sezonale dhe bukë. Sipas marrëveshjes, kjo është menyuja e ditës së premte, të javës së tretë. Por, sasi të duken shumë të vogla dhe në paketimin e gulashit me mish viçi dhe pjatën anësore me oriz të zier nuk kishte deklarata me përshkrim të përmbajtjes dhe peshës. Gjithashtu, sallata është vetëm lakër, sikur në të gjitha rastet e mëparshme të kontrolleve në terren.



Shfrytëzuesve të shujtave u është shpërndarë edhe ushqim për fundjavën e ardhshme. Përmbajtja e ushqimit të shpërndarë ngjan me menytë për ditën e shtunë dhe të diel të javës së tretë të marrëveshjes. Ditën e shtunë, kulaçë me kaçkavall dhe sallam, lëng frutash. Por, në këtë rast konkret nuk janë të qarta sasi të djathit dhe sallamit të dorëzuar. Të dielën, menyuja përbëhet nga 75 gramë pashtetë pule, djathë foshnjesh, perime sezonale (keçap) dhe bukë. Të dielën, sipas mundësisë që është dhënë, në vend të perimeve sezonale, është dhënë keçap, megjithëse nuk është e qartë se si keçapi mund të jetë një alternativë zëvendësimi për sallatën sezonale. Por, edhe keçapi që është dhënë është me sasi prej 12 gramë, ndërsa sipas normave orientuese të paraqitura në marrëveshjen, një pako e keçapit duhet të jetë me peshë 40-50 gramë. Kjo përmbledhje modeste produktesh që është paraqitur në foton duhet të ngopë një qytetar të rritur për 2 ditë dhe shteti për këto produkte paguan 478 denarë.



Gjatë vizitave në lokacionet ku shpërndaheq ushqimi në Komunën Shuto Orizarë (në një hapësirë të objektit të mëhershëm të Qendrës për Punë Sociale, më 25 nëntor 2025), në Komunën Kisella Voda (në parkun pas hapësirave të bashkësisë lokale Draçevë, më 20.11.2025) dhe në Komunën e Çairit (në oborrin e shkollës fillore “Imri Elezi”, më 19.11.2025) është konstatuar që ushqimi i shpërndarë është në përputhje me menytë sipas marrëveshjes.

Në marrëveshjen e nënshkruar për këtë prokurim publik thuhet: “Mosrespektimi i menyve javore, normave orientuese për përgatitjen e një shujtë-drekë e gatshme dhe normave orientuese për një pako shujtë-drekë të ftohtë gjatë fundjavave nga ana e Bartësit të Prokurimit, do të rezultojë me ndërprerjen e Marrëveshjes dhe arkëtim të garancisë për zbatimin me cilësi dhe në kohë të Marrëveshjes.” Gjithashtu, Bartësi i Prokurimit merr përsipër përgjegjësinë për të vepruar sipas udhëzimeve dhe kërkesave të personit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes dhe të paraqesë raporte për shpërndarjen e kryer, me nënshkrimet nga personat e autorizuar në secilin lokacion. Në marrëveshjen është paraqitur emri i personit të angazhuar për monitorimin e zbatimit të kësaj marrëveshjes, por nuk ka dispozita të përpikta në lidhje me mënyrën e kontrollit mbi zbatimin e marrëveshjes që e ushtron Ministria, me çka krijohet rrezik për abuzimin e fondeve publike.

**Është me rëndësi të theksohet se pothuajse të gjithë shfrytëzuesit e shujtave kanë thënë që problem serioz për ta janë sasi të vogla të bukës.** Në marrëveshjen aktuale të prokurimit publik, për herë të parë prej kompanive ofertuese është kërkuar të dorëzojnë “kulaç të vogël, me një paketim, me miell T-500, me sasi bruto për një porcion prej 100-150 gramë”. Në procedurat e mëparshme të tenderimit, kërkesa ishte: “bukë gruri gjysmë e bardhë, me miell T-500 (buka me peshë 500-600 gramë duhet të ndahet në dy pjesë) dhe të ketë një sasi bruto prej 250-300 gramë për porcion”.

Nuk është e qartë se çfarë e nxiti Ministrinë për të bërë këtë ndryshim të menyve dhe nëse është zhvilluar ndonjë analizë paraprake se si sasi të reduktuara të bukës do të ndikojnë mbi vlerën kalorike të shujtave. Reagimet e shfrytëzuesve flasin për dyshimin se ky ndryshim është bërë në dëm të tyre, ndërsa në interes të dhënësve të shërbimit.

Prej Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik, në formë zyrtare kemi kërkuar dëshmi për livrimet e kryera të shujtave të gatshme sipas llojit dhe sasisë, me lokacionet për datat e paraqitura si vijon- 14.11.2025; 17.11.2025; 19.11.2025; 20.11.2025; 25.11.2025; 28.11.2025; 12.12.2025 dhe 19.12.2025. Përveç kësaj, është kërkuar edhe shpjegim lidhur me mënyrën se si monitorohet zbatimi i marrëveshjes dhe të parashtrihen raporte për monitorimin mbi zbatimin, nëse kanë dokumente të tilla. Ministria nuk i dorëzoi informacionet e kërkuara në afatin e paraparë ligjor.

## Çmimet e rënë dakord në marrëveshjen janë më të larta se çmimet me pakicë dhe numri i shfrytëzuesve nuk bëhet i ditur

---

Kompania që është bartëse e kësaj marrëveshjes ka në zotërim një objekt për shitje me pakicë në qendër të qytetit. Ndër të tjera, disa nga produktet që janë pjesë e menëve nga tenderi i analizuar shiten atje. Sipas çmimeve me pakicë, 100 gramë oriz kushton 24 denarë, 100 gramë kofshë pule 67 denarë, 100 gramë biftek pule 74 denarë.

Nëse këto çmime do të përdreshin për të përlogaritur vlerën e disa prej menëve, do të rezultonte se çmimi me pakicë i disa prej tyre lëviz nga 120 deri 140 denarë.

Ndërkaq, vlera e paketave të drekës ka vlerë edhe më të ulët në shitjen me pakicë edhe atë më pak 100 denarë.

Në fakt, sipas të dhënave të disponueshme për publikun në Sistemin Elektronik të Prokurimit Publik, çmime më të ulëta për shujtat arkëtohen në qendrat ndërkomunale të punës sociale në qytete të tjera, si për shembull në Tetovë, ku çmimi është 105 denarë.

Cili është numri real i shfrytëzuesve të këtyre shujtave? Kjo është një pyetje për të cilën nuk mund të jepet përgjigjet e saktë, sepse në dokumentacionin e tenderit, si dhe në kontratën e lidhur, është shkruar që ky numër përfshin 1,000 shujta të gatshme në ditë. Mirëpo, relevanca e këtyre të dhënave vihet në pikëpyetje nga fakti se vlera e marrëveshjes së nënshkruar është më e madhe, dhe me 89,775,000 denarë mund të sigurohen shujta për 1,027 persona. Nëse është kështu, shtrohet pyetja se çka është arsyeja për rritjen e numrit të shfrytëzuesve për 26% krahasuar me vitin atë të vitit 2024? Përkatësisht, sipas njoftimit të dorëzuar për marrëveshjen e realizuar, me tenderin e mëparshëm janë shpenzuar 71,400,000 denarë për të njëjtin dedikim, shumë kjo e cila nëse përpjesëtohet me çmimin për një shujtë (240.45), rezulton që ka pasur 813 shfrytëzues të shujtave.

## Kronologjia e tenderit për prokurimin e shujtave të gatshme për shfrytëzuesit e kuzhinave popullore

Për nënshkrimin e kësaj marrëveshjes për prokurim publik me vlerë prej 89,775,000 denarë (10,459,756 euro) nevojitej të kalojnë shtatë muaj e gjysmë, dy tenderë të pasuksesshëm dhe gjashtë ankesa për të arritur përfundimisht deri te nënshkrimi i marrëveshjes për prokurimin publik të analizuar. Me këtë marrëveshje të nënshkruar në vitin 2025, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë për herë të parë shfaqet si bartëse e marrëveshjes për prokurimin e shujtave të gatshme për shfrytëzuesit e kuzhinave popullore. Më parë, këto marrëveshje janë nënshkruar nga ana e Institucioni Publik Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale e Qytetit të Shkupit. Në fakt, në vitin 2025, shpalljen së pari e ka publikuar Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale e Qytetit të Shkupit, pastaj ka pasur anulimi i tenderit dhe tenderin e mori përsipër Ministria. Sipas të dhënave të disponueshme nga SEPP, ky prokurim zbatohet që nga viti 2018. Në vitin e parë, bartësi i marrëveshjes është “Specijall produkt” SHPKPV Shkup, ndërsa pastaj “Unimerkant-ketering” Shkup e fiton tenderin për 6 vitet e ardhshme me radhë (2019-2024).

**10.02.2025:** Institucioni Publik Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale e Qytetit të Shkupit, sikur edhe vitet e kaluara, publikon shpalljen me numër rendor 01812/2025.

**12.12.2025:** Kompania “Specijall Produkt” Shkup paraqet një ankesë ndaj dokumentacionit të tenderit në lidhje me kushtet e përcaktuara për të ardhurat minimale nga veprimtaria për përgatitjen e shujtave dhe shërbim e ushqimit - shujta të gatshme prej minimum 30.000.000 denarë kumulativisht për 3 (tre) vitet e fundit me arsyetimin se me këtë kusht cenohet parimi i konkurrencës.

**27.02.2025** Komisioni Shtetëror për Ankesa për Prokurimet Publike (KSHAP) miraton një aktvendim dhe e refuzon ankesën për shkak se është e pabazuar.

**06.03.2025:** IP Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale e Qytetit të Shkupit merr vendim për anulimin e procedurës, me arsyetimin se kanë ndodhur ndryshime të paparashikuara në buxhetin e autoritetit kontraktues.

**27.05.2025** Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë shpall një thirrje për tender për prokurimin e shujtave të gatshme për shfrytëzuesit e kuzhinave popullore me numër rendor 09457/2025. Duke marrë përsipër tenderin, Ministria vendos edhe kushte të reja. Në vend që 3, kërkohen 5 mjete motorike, në vend të 3 shoferëve, kërkohen 7, në vend të 3 kuzhinierëve, kërkohen 7, si dhe 7 asistentë kuzhine dhe 1 teknolog i teknologjisë ushqimore dhe 1 teknolog i sigurisë ushqimore. Nuk ka informacion se në cilat gjetje bazohet ky ndryshim. Një nga parimet themelore të LPP-së është parimi i proporcionalitetit sipas të cilit, *procedura e prokurimit publik zbatohet proporcionalisht me lëndën e prokurimit, veçanërisht për sa i përket përzgjedhjes, përcaktimit dhe aplikimit të kushteve, kërkesave dhe kriterëve, të cilat duhet të jenë logjiksht të lidhura me lëndën e prokurimit.*

Konkretisht, Ligji për Prokurime Publike parashih mundësinë që autoriteti kontraktues të zhvillojë një dialog teknik me operatorët ekonomikë para shpalljes së konkursit për prokurim publik, duke u lejuar atyre të kenë qasje tek dokumentacioni i tenderit dhe të japin sugjerimet dhe komentet e tyre. Ministria nuk ka zhvilluar një dialog teknik për këtë procedurë të prokurimit publik.

**05.06.2025** Kompania “Specijall Produkt” Shkup paraqet një ankesë ndaj dokumentacionit të tenderit, në të cilën pretendohet se Ministria mund të çojë në diskriminimin e operatorëve ekonomikë dhe favorizimin disa operatorëve të tjerë ekonomikë, për shkak të kërkesës për të ardhura të gjeneruara në veprimtarinë 10-85 dhe strukturën e të ardhurave sipas veprimtarisë.

**09.07.2025** KSHAPP-ja miraton aktvendim me të cilin e refuzon ankesën e kompanisë “Specijall produkt” për shkak se është e pabazë.

**26.06.2025** Dita e hapjes së ofertave. Janë fituar 4 oferta për tenderin.

**03.07.2025** Ankesë paraqet Kompania “Unimerkant-ketering” Shkup. Pala ankuese deklaron se nuk i janë përgjigjur në kohën e duhur pyetjet që i ka bërë në lidhje me kushtet për pjesëmarrjen në tender.

**06.07.2025** Ankesë paraqet edhe Kompania “Industri Servis” Skopje. Në ankesën, ndër të tjera, thuhet se me kushtet e përcaktuara për pjesëmarrje favorizohet një kompani.

**18.07.2025** KSHPPA-ja i miraton pjesërisht ankesat e parashtruara nga “Unimerkant-ketering” Shkup dhe “Industri Servis” Shkup dhe e anulon dokumentacionin e tenderit dhe procedurën për Shpalljen për Prokurim Publik me Procedurë të Hapur nr. 09457/2025.

**19.07.2025** Ministria miraton vendim për anulimin e procedurës në bazë të aktvendimit të KSHAPP-së.

**22.07.2025** Ministria publikon një shpallje të re për të njëjtin prokurim publik 13225/2025. Dokumentacioni i tenderit nuk është ndryshuar.

**01.08.2025** Kompania “Unimerkant-ketering” paraqet një ankesë në lidhje me dokumentacionin e tenderit për shkak të metodës së paqartë për livrimin.

**11.08.2025** Hapja e ofertave. Oferta parashtrojnë tre kompani – “Parti Servis Leo” Shkup, “Unimerkant-ketering” Shkup dhe “Industri Servis” Shkup.

**20.08.2025** KSHAPP e refuzon ankesën e “Unimerkant-ketering” për shkak se është e pabazuar.

**26.08.2025** Ministria sjell vendimin që si oferta më e favorshme të përzgjedhet oferta e “Parti Servis Leo” Shkup.

**5.09.2025** Një ankesë e re e “Unimerkant-ketering” me pretendimin se është bërë vlerësim i pasaktë i ofertave. Një nga pretendimet ka të bëjë edhe me faktin se Ministria ka pranuar një dokument për vërtetim të kushtit për gjendjen ekonomike dhe financiare i lëshuar nga Regjistri Qendror me datë pas hapjes publike.

**17.09.2025** KSHAPP e hedh poshtë ankesën.

**24.09.2025** Ministria e nënshkruan marrëveshjen me “Parti Servis Leo” SHPKPV Shkup. Vlera e marrëveshjes është 89,775,000 denarë (1,459,756 euro). Çmimi për një shujtë është 239.40 denarë. Ky çmim është minimalisht më i ulët se ai në marrëveshjen e mëparshme të nënshkruar nga Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale e Qytetit të Shkupit, kur vlera atëherë arrinte shumën 240.45 denarë.

---

## **Rekonstruktimi i objektit të mëhershëm të Komercijallna Banka nuk ka mbarim: 51 aneks dhe një rritje prej 32% në vlerën e tenderit**

---

(Tender i Shërbimit për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta të Qeverisë për rekonstruktimin e ndërtesës së mëhershme të Komercijallna Banka me numër 17051/2022)



- Rekonstruktimi, fillimisht i planifikuar të zgjasë 18 muaj dhe të kushtonte 6.6 milionë euro, ende nuk është përfunduar pas pothuaj tre vitesh nga nënshkrimi i marrëveshjes.
- Gjatë rekonstruktimit, Shërbimi i Punëve të Përgjithshme dhe të Përbashkëta (SHPPP) dhe kompania e ndërtimit “Bauer BG” kanë lidhur gjithsej 51 aneks të marrëveshjes bazë, 10 prej të cilave brenda një dite.
- Vlera e kontratës bazë me anekset është zmadhuar për 2.1 milionë euro, ose 32% krahasuar me shumën e rënë dakord fillimisht, gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Prokurime Publike, i cili lejon një rritje prej maksimum 20%.
- Në anekset e nënshkuara janë evidentuar çështjet e paparashikuara gjatë ndërtimit dhe tepricat që janë shfaqur.<sup>1</sup> Megjithatë, vlera e marrëveshjes bazë nuk është zvogëluar për shkak të deficiteve<sup>2</sup>, të cilat kanë qenë të evidentuara, por nuk janë kompensuar me tepricat.
- Ndërkohë, nga SHPPP kërkohet që të gjejë bazë ligjore për ridedikimin e deficiteve që janë evidentuar në vlerë prej 1.1 milion euro dhe t’i mundësojë “Bauer BG” që t’i përdorë ato për realizimin e pozicioneve të parashikuara rishtas nga zgjidhjet e reja teknike dhe projektin e ri për mbrojtjen KZ në ndërtesën. Ligji për Prokurime Publike nuk parasheh ridedikimin e deficiteve dhe përdorimin e tyre në pozicione të parashikuara rishtas.
- Me punimet e kryera të paparashikuara me vlerë prej rreth 1.2 milion euro, tepricat e ndërtimit prej 978 mijë euro dhe deficitet e ndërtimit prej 1.1 milion euro, rezulton se projekti për rekonstruktimin e objektit të vjetër të Komercijallna Banka është ndryshuar madje deri 49% nga specifikacionet fillestare të projektit. Veprimi i këtillë është problematik nëse e marrim parasysh qëndrimin e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, që marrëveshjet për prokurime publike mund të pësojnë ndryshime që janë të papërfillshme.
- Raportet e përgatitura nga kompania që ushtron mbikëqyrjen mbi rekonstruktimin sugjerojnë në mënyrë plotësuese për pasigurinë financiare rreth realizimit të plotë të rekonstruktimit të këtij objekti shtetëror.
- SHPPP ka dhënë pajtim dy herë për prolongimin e afatit të ndërtimit. Herën e parë deri në dhjetor të vitit 2025 dhe herën e dytë deri në qershor 2026.
- Duke qenë se afati për ndërtimin e këtij objekti shtetëror prej 18 muajsh nga “vënia në funksionim” ka qenë kusht i përcaktuar në dokumentacionin e tenderit, ndryshimi i tij paraqet shkelje mbi parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.
- Në periudhën janar-qershor 2026, pra vetëm për 6 muaj, “Bauer BG” duhet të kryejë 37% të rekonstruktimit të paraparë. Më parë, kjo kompani kishte kryer vetëm 63% për një periudhë prej 26 muajsh.
- Edhe pse marrëveshja parasheh penale kontraktuale në rast vonese nga realizuesi, SHPPP deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për t’i aplikuar këto masa për mbrojtjen e resurseve publike.

1 Tepricat janë punime të kryera që tejkalojnë sasinë e kontraktuara të punimeve.

2 Mungesat janë devijime negative nga puna e kryer në lidhje me sasinë e punës së rënë dakord.

## “Progres” në vonesë

Marrëveshja për prokurimin publik për rekonstruktimin e objektit të mëhershëm të Komercijallna Banka është nënshkruar në prill të vitit 2023. Procedura e tenderit filloi në vitin 2022 dhe në të kanë marrë pjesë 4 kompani (“Strabag AG”, “Zhikoll” Strumica, “Ak-Invest” Tetovo dhe “Bauer BG” Shkup).

Pas ankandit elektronik të zhvilluar dhe uljes së mëtejme të ofertave të paraqitura fillimisht, si oferta më e favorshme bazuar në kriterin ‘çmimi më i ulët’ është përzgjedhur oferta e “Bauer BG”. Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë me çmimin më të ulët, që më pas rritet konsiderueshëm, sikur në këtë rast, vë në pikëpyetje të gjithë procedurën e prokurimit publik, përkatësisht respektimin e parimeve të transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

<b>PËRMBLEDHJE TOTALE (në denarë)</b>	
<b>PËR REKONSTRUKTIMIN E NDËRTESES SË MËHERSHME TË KOMPERCIJALLNA BANKA (PALLATI KAÇKM - SHKUP) OBJEKTI-1 (BISER DHE PJESA E RE) DHE OBJEKTI-2 (PJESA E VJETËR)</b>	
<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>Çmimi total pa TVSH</b>
BISER	43,039,308
PJESA E RE	179,312,636
PJESA E VJETËR	121,448,056
<b>TOTALI PA TVSH-në</b>	<b>343,800,000</b>
TVSH 18%	61,884,000
<b>VLERA TOTALE E KONTRATËS</b>	<b>405,684,000</b>

Vlera e marrëveshjes së nënshkruar është 405,684,000 denarë, ose 6,596,488 euro. Sipas marrëveshjes, rekonstruktimi i objektit shtetëror duhej të përfundonte brenda 18 muajve nga vënia në situatë. Sipas dokumentacionit që na është siguruar, “Bauer BG” është vënë në situatë madje 7 muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes, përkatësisht më 20.11.2023.

Rekonstruktimi nuk është zhvilluar sipas planit që nga fillimi. Por, duket sikur gjërat nuk janë vënë nën kontroll as dy vjet pasi ka filluar rekonstruktimi.

Në dhjetor 2025, nga Mbikëqyrja në raport kanë konstatuar që “janë mbajtur disa takime midis Investituesit, Mbikëqyrjesit, Auditorit dhe Projektuesit, në të cilat nga ana e menaxhmentit më të lartë të Investituesit - SHPPP, Projektuesit dhe Auditorit edhe një herë u është sugjeruar për rëndësinë e dorëzimit të gjithë dokumentacionit të kërkuar të projektit, zgjidhjeve të reja teknike. Vonesa me dorëzimin e zgjidhjeve të reja teknike të reviduara e rrezikon shumë dinamikën e rekonstruktimit, prandaj afati i ndërtimit është prolonguar për herë të dytë për 6 (gjashtë) muaj shtesë, pas prolongimit të mëparshëm prej 7 (shtatë) muajsh për të njëjtat arsye. Pas mbajtjes së takimeve javore midis Investituesit, Mbikëqyrjes, Auditorit dhe Projektuesit, të gjitha zgjidhjet teknike që mungonin u dorëzuan nga Projektuesi më datën 26.12.2025. Auditori ka bërë të ditur se vërejtjet në lidhje me zgjidhjet teknike të paraqitura janë minimale dhe se të gjitha zgjidhjet teknike të reviduara do t’i dorëzohen Investituesit më datë 13.01.2026”.

Sipas raporteve të Mbikëqyrjes, vonesat i atribuohen kryesisht dorëzimit të vonuar të zgjidhjeve teknike nga projektuesit për të gjitha fazat, por në periudha të caktuara, janë dhënë udhëzime që “Bauer BG” ta zmadhojë numrin e punëtorëve në pozitat për të cilat nuk ka asnjë pengesë për punë.

## Tepricat janë arkëtuar, ndërsa deficitet vetëm janë evidentuar

Kronologjikisht, aneksi i parë i marrëveshjes bazë është nënshkruar 24 ditë pas fillimit të rekonstruktimit. Gjatë një periudhe prej 2 vitesh, janë nënshkruar 51 aneks të marrëveshjes, nga të cilat në disa ditë janë nënshkruar edhe nga disa anekse.

Jo të gjitha anekset e nënshkruara janë dorëzuar në Sistemin Elektronik të Prokurimeve Publike. SHPPP nuk e ka respektuar këtë detyrim ligjor. Siç mund të shihet nga paraqitja tabelore më poshtë, njoftime të tilla janë dorëzuar për 32 anekse, edhe atë me vonesa të konsiderueshme, ndërsa për 19 anekse të nënshkruara, SHPPP nuk ka dorëzuar asnjë njoftim. Për nevojat e këtij hulumtimi, anekset i kemi siguruar përmes kërkesës për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik.

Lista e anekseve të nënshkruara të marrëveshjes për rekonstruktimin e objektit të vjetër të Komercijallna Banka

Numri i aneksit	Data e nënshkrimit të aneksit-ndryshim i marrëveshjes së nënshkruar	Data e publikimit të ndryshimit të marrëveshjes së nënshkruar në SEPP	Miratimi i vlerës së tepricave, në denarë	Miratimi i vlerës së punëve të paparashikuara, në denarë
1	13.12.2023	25.08.2025	572,575	
2	25.02.2024	05.12.2025		8,447,477
3	11.04.2024	05.12.2025		4,985,468
4	19.04.2024	Nuk është publikuar	616,461	
5	04.06.2024	09.12.2025		1,620,246
6	05.06.2024	Nuk është publikuar	789,256	
7	22.08.2024	Nuk është publikuar	224,456	
8	22.08.2024	09.01.2025		1,080,205
9	10.09.2024	Nuk është publikuar	702,650	
10	18.09.2024	Nuk është publikuar	1,044,120	
11	30.09.2024	09.12.2025		12,358,640
12	17.10.2024	Nuk është publikuar	536,125	
13	31.10.2024	10.12.2025		1,931,574
14	10.12.2024	10.12.2025		2,711,704
15	10.12.2024	10.12.2025		5,623,786
16	10.12.2024	10.12.2025		1,374,686

17	21.01.2025	11.12.2025		1,302,833
18	23.12.2024	Nuk është publikuar	407,159	
19	30.01.2025	12.12.2025		499,730
20	03.02.2025	12.12.2025		5,220,563
21	06.02.2025	12.12.2025		1,116,374
22	06.02.2025	Nuk është publikuar	3,719,322	
23	10.03.2025	15.12.2025		4,034,546
24	10.04.2025	Nuk është publikuar	3,537,707	
25	10.04.2025	16.12.2025		623,916
26	29.04.2025	Nuk është publikuar	5,237,218	
27	27.06.2025	16.12.2025		888,000
28	20.05.2025	Nuk është publikuar	Prolongim i afatit të ndërtimit deri më 20.12.2025	
29	27.06.2025	Nuk është publikuar	3,616,741	
30	27.06.2025	16.12.2025		1,985,645
31	27.06.2025	17.12.2025		2,294,153
32	27.06.2025	Nuk është publikuar	5,907,283	
33	04.08.2025	Nuk është publikuar	1,167,646	
34	04.08.2025	17.12.2025		1,410,395
35	04.08.2025	17.12.2025		366,347
36	07.08.2025	17.12.2025		1,330,898
37	07.08.2025	18.12.2025		1,734,010
38	07.08.2025	18.12.2025		2,012,013
39	07.08.2025	18.12.2025		157,006
40	07.08.2025	Nuk është publikuar	5,729,373	
41	19.12.2025	24.12.2025	Prolongim i afatit të ndërtimit deri më 20.06.2026	
42	23.01.2026	Nuk është publikuar	8,104,974	
43	23.01.2026	03.02.2026		1,861,191
44	23.01.2026	Nuk është publikuar	9,836,720	
45	23.01.2026	03.02.2026		1,255,815
46	23.01.2026	03.02.2026		1,072,000
47	23.01.2026	Nuk është publikuar	4,049,546	
48	23.01.2026	03.02.2026		552,481
49	23.01.2026	03.02.2026		371,243
50	23.01.2026	03.02.2026		951,780
51	23.01.2026	Nuk është publikuar	4,357,073	
<b>VLERA TOTALE NË DENARË</b>			<b>60,156,405</b>	<b>71,174,725</b>
<b>VLERA TOTALE NË EURO</b>			<b>978,153</b>	<b>1,157,313</b>
<b>VLERA TOTALE E ANEKSUAR NË DENARË</b>				<b>131,331,130</b>
<b>VLERA TOTALE E ANEKSTUAR NË EURO</b>				<b>2,135,466</b>

Rezultoni se marrëveshja bazë është aneksuar 30 herë për shkak të realizimit të punimeve të paparashikuara edhe atë për 71,174,725 denarë, përkatësisht për 1,157,313 euro. Ndërkaq, aneksi i për shkak të tepricave të realizuara është bërë 19 herë dhe vlera totale e tepricave është 60,156,405 denarë, ose 978,153 euro.

Në total, të gjitha këto anekse çojnë drejt rritjes së vlerës së marrëveshjes bazë për 2,135,466 euro, ose për 32% në krahasim me shumën e rënë dakord fillimisht prej 6.6 milionë euro.

**Sipas anekseve të nënshkruara, mund të konkludohet se gjatë ndërtimit janë shfaqur vetëm teprica. Megjithatë, raportet e mbikëqyrjes zbulojnë se është mbajtur edhe evidencë e përpiktë për deficitet (ajo që ka qenë e nevojshme, por nuk është harxhuar gjatë rekonstruktimit) dhe se vlera e tyre është edhe më e lartë se tepricat për të cilat janë nënshkruar anekset.**

Teprica/deficite	Shuma në denarë
Tepricat e miratuara kumulative	60,156,407
Tepricat e realizuara / të arkëtuara në mënyrë kumulative	58,185,399 Përqindja e Pajtueshmërisë 14.34%
Pasqyra aktuale e deficiteve me përfundim me situatën 23-të periodike	66,315,312 Përqindja e Pajtueshmërisë 16.34%

Sipas qëndrimit të Byrosë për Prokurime Publike të deklaruar në faqen e tyre të internetit<sup>3</sup>, në përputhje me nenin 117 paragrafi (3) të Ligjit për Prokurime Publike, për përgjegjësinë e palëve kontraktuese për përmbushjen e detyrimeve nga marrëveshja, përveç dispozitave të këtij ligji, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e ligjit që rregullon marrëdhëniet e detyrimeve dhe rregulloret materiale me të cilat rregullohet lënda e prokurimit. Së këtejmi, **mënyra e veprimit në rast të tepricave dhe deficiteve duhet të jetë e rregulluar me marrëveshjen në përputhje me praktikën profesionale në ndërtimtarin, me rregulloret materiale në ndërtimtarin dhe rregulloret materiale që rregullojnë marrëdhëniet e detyrimeve.** Në përputhje me praktikën profesionale, tepricat dhe deficitet kompensohen njëra me tjetrën dhe evidentohen në librin e ndërtimit që mbahet nga realizuesi i punimeve, ndërkaq vërtetohen nga inxhinieri mbikëqyrës. Çështjet shtesë dhe të paparashikuara duhet të rregullohen në përputhje me dispozitat që ndërlidhen me ndryshimet në marrëveshjen për prokurimin publik gjatë afatit të vlefshmërisë së saj (neni 119), duke mbajtur llogari që vlera totale e ndryshimeve të marrëveshjes së prokurimit publik të mos tejkalojë 20% të vlerës së marrëveshjes fillestare. Gjatë kësaj, në këto 20% që nuk duhet ta tejkalojnë vlerën e marrëveshjes fillestare, përveç punëve shtesë dhe të paparashikuara, përlllogariten edhe tepricat tjera të pakompensuara.

Mënyra e veprimit me tepricat dhe deficitet duhet të ketë qenë e rregulluar me marrëveshjen e nënshkruar midis SHPPP-së dhe "Bauer BG". Megjithatë, meqenëse kjo nuk është bërë, rezultoni se anekset janë përdorur për t'i miratuar tepricat gjatë rekonstruktimit, gjatë kësaj pa u kompensuar deficitet gjatë ndërtimit. Prandaj, shtrohet pyetja, nëse për çdo tepricë është nënshkruar një aneks, pse nuk është vepruar në të njëjtën mënyrë edhe për secilin deficit?

3 <https://www.bjn.gov.mk/faq/izmeni-na-dogovorot-vo-tekot-na-negovata-vaznost/>

Sipas raporteve të kompanisë që e zbaton mbikëqyrjen, rezulton që deficitet në rekonstruktimit kanë një trajtim të dyfishtë. Nga njëra anë, ato janë “hequr” kur në raportet është përlogaritur vlera e rritjes së marrëveshjes bazë me qëllim që të mbetet nën limitin e përcaktuar ligjor prej 20 %, kurse nga ana tjetër, nga SHPPP-ja kërkohet të gjejë një bazë ligjore për ridedikimin e deficiteve dhe përdorimin e tyre për ecurinë e mëtejshme të ndërtimit.

Më konkretisht, në raportin mujor (01.12-31.12.2025) nga kompania që e zbaton mbikëqyrjen e rekonstruktimit, “Energo Dizajn” SHPK Shkup, thuhet: **“Në takime është diskutuar edhe në lidhje me realizimin financiar të projektit, ku nga ana e Mbikëqyrësit është sqaruar se ecuria e deritanishme e projektit është zbatuar në suazat ligjore prej 20% të punimeve të paparashikuara, shtesë dhe tepricave dhe që shumica e fondeve të realizuara në punimet e paparashikuara janë për shkak të gabimeve në dokumentacionin e projektit. Meqenëse zgjidhjet e reja teknike parashikojnë pozicione që nuk janë pjesë integrale e paramatjes-përlogaritjes nga Marrëveshja bazë, Investitori është i detyruar të gjejë një kornizë ligjore për ridedikimin e deficiteve dhe përdorimin e tyre për pozicionet e reja të parashikuara nga zgjidhjet e reja teknike, si dhe nga projekti i ri për mbrojtjen KZ për hapësirën për vendosjen e agregatëve dizel. Nga ana e Mbikëqyrësit gjithashtu është theksuar që nëse gjendet korniza ligjore për përdorimin e deficiteve nga paramatja-përlogaritja e projektit bazë, ka fonde të mjaftueshme financiare për përfundimin e Pjesës së Vjetër të Objektivit, përkatësisht për zbatimin e plotë të projektit. Realizimi financiar i pjesës tjetër të projektit varet nga fondet që do të jenë të nevojshme për realizimin e projektit të ri KZ, si dhe nga pozicionet e reja që janë parashikuar me zgjidhjet tjera të reja teknike.”**

Në drejtim të perspektivave të pafavorshme për zbatimin e kësaj marrëveshjes për prokurimin publik flet edhe informacioni i mëposhtëm i paraqitur nga mbikëqyrësi: “Realizuesi i ka paraqitur një kërkesë deri tek Investitori për ndryshim të çmimeve për shkak të vonesave në zbatimin e projektit, ndërsa këto shkaqe nuk janë me faj të Realizuesit.”

Mbetet e paqartë pse shfaqet kjo çështje, duke e pasur parasysh se marrëveshja e nënshkruar në nenin 4 thotë: *“Palët Kontraktuese pajtohen me çmimet nga Oferta e Realizuesit pas ankandit elektronik të zhvilluar më 30.12.2022, i cili përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje. Çmimet nga paragrafi i mëparshëm, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen asnjë korrigjimi, për asnjë arsye. Çmimet nga paragrafi (1) i këtij neni i përfshijnë të gjitha shpenzimet e Realizuesit, punën dhe fuqinë punëtore, materialet dhe punën hulumtuese, shpenzimet për transportin dhe shpenzimet e tjera për kryerjen e punimeve, detyrimet publike, lirimet, si dhe doganat për importin, nëse ka.*

*Vlera e kësaj Marrëveshjeje pa tatimin mbi vlerën e shtuar të përlogaritur është 343,800,000 denarë. Tatimi mbi vlerën e shtuar është 61,884,000 denarë. Vlera totale e kësaj Marrëveshjeje me tatimin mbi vlerën e shtuar të përlogaritur është 405,684,000 denarë.*

Në këtë rast, problematik është edhe fakti që afati prej 18 muajsh për ndërtimin e objektit shtetëror nga “vënia në punë” ka qenë kusht i përcaktuar në dokumentacionin e tenderit. SHPPP është pajtuar dy herë për prolongim të afatit të ndërtimit, herën e parë deri në dhjetor 2025 dhe herën e dytë deri në qershor 2026. Ndryshimi i afatit që ishte kusht në dokumentacionin e tenderit përbën shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, sepse afati më i gjatë i rekonstruktimit mund të kishte ndikuar mbi çmimet e ofruara, si dhe në mundësinë që edhe kompani tjera të marrin pjesë.



Në konkluzionin se marrëveshja është nënshkruar dhe është harruar shpie edhe informacioni që SHPPP-ja në periudhën e kaluar nuk ka vepruar në përputhje me nenet 7 dhe 33 të marrëveshjes së nënshkruar. Sipas nenit 7, "Nëse 'Realizuesi' nuk e kryen punën me kohë dhe me cilësi ose nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen, Porositësi mund ta inkasojë garancinë bankare nga neni i mëparshëm i kësaj Marrëveshjes në favor të vet."

Neni 33 i marrëveshjes ndër të tjera thotë: "Në rast se Realizuesi nuk i përmbush detyrimet e tij sipas marrëveshjes, Porositësi mund të kërkojë ose menjëherë të përmbushet detyrimi ose të paguhet ndonjë penal i përcaktuar me marrëveshjen. Penali i përcaktuar në marrëveshjen është 5% e çmimit total për kryerjen e punimeve, lëndë e kësaj Marrëveshjes..."

Fakti që SHPPP nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të përmbushjes së dispozitave të marrëveshjes flet për shpërfillje të plotë të parave publike. Nuk është e qartë se si është e mundur të tolerohet mosrespektimi i një marrëveshjeje të nënshkruar dhe të mos kërkohet përgjigje nga palët e përfshira në procesin e realizimit të rekonstruktimit të këtij objekti shtetëror.

**Në realizimin e këtij tenderi problematik është edhe vëllimi i ndryshimeve që janë bërë në lidhje me realizimin.** Me punimet e paparashikuara që janë zbatuar (1,157,313 euro), tepricat ndërtimore (978,153 euro) dhe deficitet ndërtimore (1,078,298 euro), rezulton që projekti për rekonstruktimin e objektit të vjetër të Komercijallna Banka është ndryshuar madje deri në 49% të specifikacioneve fillestare në projektin prej 6.6 milionë euro.

Ndryshimi i marrëveshjes së nënshkruar përbën shkelje të parimeve të transparencës dhe trajtimit të barabartë, ndërsa me dispozitat e Ligjit për Prokurime Publike nuk është i lejuar veprimi i tillë, që mund të ndikojë në çrregullimin e tregut. Ky veprim është problematik nëse merret parasysh edhe qëndrimi i Gjykatës së Drejtësisë së BE-së që marrëveshjet për prokurime publike mund të pësojnë ndryshime që janë të papërfillshme. Sipas Gjykatës, një ndryshim në marrëveshje konsiderohet thelbësor kur me të instalohen kushte të cilat, nëse do të ishin pjesë e procedurës së prokurimit publik, do të kishin bërë të mundur të kualifikohen ofertues të tjerë përveç atyre që janë pranuar fillimisht ose të pranohet ndonjë ofertë tjetër nga ajo e që është pranuar fillimisht. Në parim, marrëveshjet mund të ndryshohen, vetëm me kusht që ato ndryshime të mos jenë thelbësore.

## Kronologjia e tenderit për rekonstruktimin e objektit të vjetër të Komercijallna Banka

**07.10.2022** Shërbimi për Punë të Përgjithshme dhe të Përbashkëta publikon shpallje për procedurën për prokurimin publik Rekonstruktimi i objektit të mëhershëm të Komercijallna Banka me numër 17051/2022.

**22.11.2022** Në ditën e hapjes së ofertave, janë fituar 4 oferta nga: AK-INVEST Tetovo, STRABAG AG, Bauer BG Shkup dhe ZHIKOL Strumica. Ofertat e parashtruara nga AK-INVEST Tetovo dhe STRABAG AG janë hedhur poshtë. Komisioni ka konstatuar që garancioni bankar i paraqitur nga AK-INVEST Tetovë, i lëshuar nga Komercijallna Banka SHA Shkup, për pjesëmarrjen në tender ka qenë i papranueshëm, për shkak se ka qenë i lëshuar për një shpallje me numër tjetër 10751/2022, përkatësisht në të është shënuar numri i gabuar i shpalljes 10751/2022, në vend të numrit 17051/2022. Ndërsa oferta e STRABAG AG është hedhur poshtë për shkak se kanë dorëzuar dokumente që vërtetojnë se nuk janë gjykuar me datë pas hapjes së ofertave.

**31.12.2022** - zhvillohet një ankand elektronik në të cilin marrin pjesë vetëm Bauer BG Shkup dhe ZHIKOL Strumica. Çmimin e parë Bauer BG e zvogëlon nga 418,850,853 në 343,800,000 denarë, kurse kompania Zhikoll nga 483,565,464 e zvogëlon në 414,662,853 denarë pa TVSH.

**11.01.2023** në përputhje me kriterin për përzgjedhje “çmimi më i ulët”, është sjell vendimi që oferta e Bauer BG të përzgjedhet si oferta më e favorshme.

**01.02.2023** kompania AK INVEST Tetovo paraqet ankesë ndaj vendimit, duke me mendimin se nuk duhet ta kishin refuzuar ofertën e tyre për shkakun që garancioni bankar ka pasur numrin e gabuar dhe kjo nuk ishte me fajin e tyre.

**22.02.2023** KSHAPP-ja miraton aktvendim me të cilin ankesa e ankimesit AK INVEST Tetovo refuzohet për shkak se është e pabazë.

**06.04.2023** është nënshkruar marrëveshja midis SHPPP dhe “Bauer BG” Shkup.

**13.12.2023 - 23.01.2026** – janë lidhur 51 aneks.

---

## **NP “Rrugët Shtetërore”, për 13 ekspertë të angazhuar rishtazi për korridoret VIII dhe X-d, në nivel vjetor do të paguajë sa për 92 punonjës**

---

(Tenderi i Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore për asistencë teknike për ndërtimin e akseve të autostradës në Korridorin VIII dhe Korridorin X-d me numër: 10862/2025)



Fotoja është marrë nga një raport mbi realizimin e projektit<sup>4</sup>

---

4 <https://roads.org.mk/wp-content/uploads/2025/10/IMF-Report-August-2025-.pdf>

- Kostot për ndërtimin e akseve të autostradave në Korridoret VIII dhe X-d vazhdojnë të rriten – përkrah marrëveshjeve për ndërtim dhe për mbikëqyrje, në nëntor të vitit 2025 është nënshkruar edhe një marrëveshje për asistencë teknike me ekspertizë për punonjësit e Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore me vlerë prej 3.8 milionë euro.
- Tenderi për asistencën me ekspertizë është zhvilluar në bazë të një programi të vjetër projekti, të përgatitur para fillimit të aktiviteteve ndërtimore në korridoret dhe pasi tashmë ishin shpenzuar 381 milion euro<sup>5</sup>.
- Marrëveshja është nënshkruar dy vite pas formimit të njësisë së posaçme për projekte për ndërtimin e akseve të autostradës dhe pasi numri i punonjësve në kompani është rritur për 42% (nga 352 në 501).
- Vlerat e honorarëve të ekipit të angazhuar maqedonas-serb lëvizin mes shumave 13,000 dhe 23,000 euro në muaj, për një ekspert. Megjithatë, pjesa më e madhe e ekspertëve do të jenë të angazhuar për 50% të kohës së tyre, ndërsa një pjesë prej tyre edhe për më pak.
- Për 4 vite angazhim, udhëheqësi i ekipit do të fitojë 550,000 euro. Tetë ekspertë do të fitojnë kompensim, vlera e të cilit lëviz mes shumave 272,000 dhe 500,000 euro, veçmas për secilin, ndërsa katër prej tyre janë me marrëveshje për vlerë më të vogël – mes 38,000 dhe 156,000 euro.
- Në ekipin e ekspertëve është edhe një person nga njësia e projekteve për implementim të projekteve të Bankës Botërore e formuar në Ministrinë e Transportit. Kompensimi mujor i saj në Ministrinë, sipas të dhënave në ‘Otvoreni finansii’ (Financa të hapura) është 1,600 euro bruto (99,000 denarë), ndërkaq si eksperte, “Ndërmarrja për Rrugë Shtetërore” e paguan atë 10 herë më tepër, përkatësisht 15,600 euro në muaj.
- Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore do të paguajë rreth 950,000 euro në vit për këta 13 ekspertë –shumë ekuivalente me pagat neto dhe shtojcat për 92 punonjës, duke e pasur parasysh se paga e tyre mesatare neto është 862 euro.
- Vlera e honorarëve të ekspertëve të angazhuar rishtazi është disa herë më e lartë se çmimi, të cilin NP për Rrugët Shtetërore e paguan për shërbime konsulence të profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Civile, 1,300 euro në muaj.
- Megjithatë, në “Rrugët Shtetërore” këta honorarë jashtëzakonisht të lartë kanë qenë diçka e pritur. Përkatësisht, vlera e parashikuar e tenderit nuk është bërë publike, por ekipi i vetëm i ofertuesve e ka qëlluar atë me diferencë prej 0.02%.
- Kontrata për angazhimin e 13 ekspertëve gjatë një periudhe prej 4 vitesh është nënshkruar me ofertuesin e vetëm SAFEGE Skopje, i cili për shkak të sfondit të vet të vogël financiar dhe profesional, mbështetet nga Suez Consulting (SAFEGE) Francë dhe nga SAFEGE Beogradi.
- Shtatë ekspertë në ekip janë nga Maqedonia dhe gjashtë nga Serbia. Asnjëri prej tyre nuk është i punësuar në SAFEGE Shkup. Të gjithë kanë lidhur marrëveshje për bashkëpunim afarist dhe teknik me kompaninë.
- Honorarët e lartë hapin pyetje serioze në lidhje me elementin ekonomik, arsyeshmërinë dhe efektivitetin e shpenzimit të fondeve publike.
- Programi i projektit është i gjerë dhe i detajuar formalisht, por në thelb bazohet në aktivitete përshkruese pa tregues performanci që janë qartë të përcaktuar, gjë që e bën të pamundur që në mënyrë objektive të vërtetohet nëse angazhimi prej 3.8 milionë euro është i arsyetuar dhe nëse fondet publike shpenzohen në mënyrë efikase.
- Marrëveshja është nënshkruar pa specifikuar objektiva të matshëm, sasiorë dhe cilësorë që duhen përmbushur.
- Koncepti i këtillë i angazhimit krijon një rrezik të zmadhuar nga përmbushja formale e detyrimeve të marrëveshjes pa vlerë të shtuar thelbësore, pagesë të automatizuar bazuar në raporte pa kritere të qarta për cilësi, si dhe rrezik nga shpenzimi joekonomik dhe jo transparent i fondeve publike.

5 <https://roads.org.mk/wp-content/uploads/2026/01/IMF-Report-November-2025.pdf>

## Programi i projektit për tenderin është hartuar para fillimit të aktiviteteve të ndërtimit

Programi i projektit mbi bazën e të cilit u zhvillua procedura e tenderit për Asistencë teknike për ndërtimin e akseve të autostradave në Korridorin VIII dhe Korridorin X-d në periudhën 2024-2025, shfaq disa ndryshime të vogla, por në objektivin e vet, rezultatet e pritura dhe detyrat që duhen kryer nga ekspertët, është pothuajse identik.

Konstatimi që programi është përgatitur pas miratimit të ligjit të posaçëm, por para fillimit të ndërtimit, përkatësisht në vitin 2023, rezulton nga fakti se në pjesën hyrëse të tij thuhet: “Akset: Tetovë - Gostivar - Bukojçan, Trebenishtë - Strugë – Qafë Thanë dhe Prilep - Manastir janë afërsisht 110 km të gjata, dhe në përputhje me Ligjin për Përcaktimin e Interesit Publik dhe Emërimin e një Partneri Strategjik për Zbatimin e Projektit për Ndërtimin të Korridoreve Infrastrukturore VIII dhe X-d të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 163, më 16 korrik 2021 (“Ligj special”), në tekstin vijues do të përdoren si “Projekti”, ato duhet të ndërtohen në nivel autostrade. **Punimet ndërtimore për ndërtimin e akseve: Tetovë - Gostivar - Bukojçan, Trebenishtë - Strugë - Qafë Thanë dhe Prilep - Manastir pritet të fillojnë në vitin 2024**, ndërsa do të financohen në përputhje me “Ligjin Special”. Afati për ndërtimin pritet të jetë 46 muaj.”

Rezultatet që duhet t’i përmbush Konsulenti kanë të bëjnë me zbatimin e saktë dhe të papenguar të detyrave të mëposhtme:

1. Të ndihmojë Njësinë për implementim të Projektit (NJIP) të menaxhojë dhe mbikëqyrë zbatimin e Marrëveshjes bazë si dhe të nënkontratave që rezultojnë nga ajo Marrëveshje bazë me realizuesin, Marrëveshjes për mbikëqyrje dhe Këshilltar juridik për transaksione për ndërtimin e Korridorit VIII dhe Korridorit X-d dhe të sigurojë garanci për cilësi sipas kërkesave nga marrëveshjet;
2. Të ndihmojë NJIP-në lidhur me menaxhimin, vëzhgimin dhe mbikëqyrjen e Projektit në përputhje me normat evropiane dhe standardet e procedurat lokale;
3. Të ndihmojë NJIP-në për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, të monitorojë përgatitjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme dhe të përkujdeset për informimin e hershëm për nevojën lidhur me to (studime, analiza, raporte, leje, etj.), të mbikëqyrë zbatimin e masave për zbutje gjatë vizitave në lokalitetet ndërtimore (secilën herë që është e nevojshme), të sigurojë ndihmë për NJIP-në gjatë përgatitjes së raporteve në lidhje me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale, si dhe çdo çështje tjetër ekologjike dhe sociale që mund të shfaqet gjatë zbatimit të projektit;
4. Të ndihmojë NJIP-në gjatë hartimit dhe miratimit të procedurave dhe praktikave për zbatimin e planit për menaxhim, punë dhe mirëmbajtje të Korridorit VIII dhe Korridorit X-d;
5. Të ndihmojë NJIP-në gjatë vlerësimit të ofertave teknike dhe komerciale për tenderët për realizuesit e specializuar dhe vlerësimin e nënkontratave, në bazë të të cilave NJIP do të mund të bëjë një përzgjedhje cilësore të realizuesit të specializuar si dhe ta ndihmojë gjatë përkufizimit e nënkontratave.
6. Pjesëmarrje aktive në takimet e grupeve për miratim dhe kontroll financiar të projekteve (DLG dhe PMB).
7. Identifikimi e hershëm dhe informimi i NJIP-së për rreziqet për kërkesa potenciale për dëmshpërblim nga realizuesi dhe realizuesit e specializuar, si dhe të zhvillojë vlerësim dhe strategji për zgjidhjen e kërkesave për dëmshpërblime.

Gjatë kësaj, në përputhje me programin e projektit, detyrimet janë të ndara në tre kategori:

- » **Detyra 1:** Të sigurohet ndihmë në fazën e përgatitjes së dokumentacionit të projektit.
- » **Detyra 2:** Të sigurohet ndihmë gjatë menaxhimit me marrëveshjet.
- » **Detyra 3:** Të sigurohet ndihmë në zhvillimin e një plani për punë dhe mirëmbajtje.

Programi i projektit nuk përmban asnjë informacion në lidhje me ecurinë e projektit, megjithëse ai filloi të zbatohet në mars të vitit 2023, përkatësisht 27 muaj para shpalljes për prokurimin publik për asistencë teknike me ekspertizë. Raportet për zbatimin e projektit, me kërkesë të FMN-së, janë të disponueshme për publikun në faqen e internetit të NP për Rrugët Shtetërore me informacione relevante në lidhje me ecurinë e punimeve, problemet e identifikuara, numrin e punëtorëve të angazhuar, pajisjet e angazhuara, fondet e paguara, prolongimin e afatit për ndërtimin për 2 vjet, etj. Megjithatë, **në programin e projektit, që është një udhërrëfyes për ofertuesit potencialë, nuk përmendet asnjë fjalë për këto raporte të zhvilluara nga mbikëqyrësi, e as për ndonjë dokumentacion tjetër shtesë që do t'u vihej në dispozicion atyre për një përcaktim më të saktë të detyrimeve të ekspertëve.** Sipas raporteve të disponueshme për publikun, deri në publikimin e shpalljes për prokurimin publik në bazë të cilit është nënshkruar tenderi i analizuar, Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore i janë paguar 20.4 miliardë denarë, ose 332 milionë euro nga Ministria e Transportit për ndërtimin e akseve të autostradave në Korridorin VIII dhe Korridorin X-d<sup>6</sup>. Duke e pasur parasysh vlerën e parashikuar të projektit në shumën prej 1.319 miliardë euro, rezulton që 25% e fondeve janë financuar tashmë. Kjo shumë është rritur në 381 milion euro deri në kohën e nënshkrimit të marrëveshjes.

Së këtejmi, statusi dhe vlerësimet e fituara nga ecuria e deritanishme e zbatimit të projektit do të ishin jashtëzakonisht të rëndësishme për ofertuesit potencialë, që ata të mund në mënyrë objektive dhe bazuar në parametra të qartë ta vlerësojnë fushëveprimin e punës dhe kompleksitetin e proceseve dhe përkitazi, të paraqesin një ofertë financiare.

Përveç kësaj, me të drejtë mund të supozohet se pas dy vite e gjysmë të zbatimit të projektit, shumë aktivitete që janë planifikuar, tashmë janë përfunduar ose janë në fazën përfundimtare, si për shembull “përgatitja e një programi të projektit”. Nga ana tjetër, rreziqet dhe problemet në terren njihen në detaje, por ato nuk janë paraqitur në programin e projektit.

Sipas kësaj, mund të vlerësohet që duke e pasur parasysh se detyrat dhe aktivitetet e cekura janë shkruar para se të fillonte zbatimi i projektit, është i arsyeshëm rreziku se detyrat dhe aktivitetet e përcaktuara të mos jenë të përshtatura me prioritetet dhe nevojat aktuale, gjë që e vë në pikëpyetje arsyeshmërinë e shpenzimit të fondeve publike dhe efikasitetin e angazhimit të ekspertëve.

---

6 <https://roads.org.mk/wp-content/uploads/2025/08/IMF-Report-June-2025.pdf>

## Tenderi për asistencën me ekspertizë u zhvillua në gjysmën e dytë të vitit 2025, përkatësisht 2 vjet pas fillimit të ndërtimit dhe pasi tashmë ishin shpenzuar 332 milionë euro

Ndihma me ekspertizë është kërkuar dy vjet pas formimit të njësisë së projektit për implementimin e projektit. Konkretisht, me një vendim të Qeverisë në qershor të vitit 2023, NP për Rrugët Shtetërore ka formuar njësi projekti për implementimin e projektit për ndërtimin e Korridoreve infrastrukturore VIII dhe X-d.

NP për Rrugët Shtetërore pas fillimit të ndërtimit të akseve të autostradës e ka rritur numrin e të punësuarve për 149 persona, përkatësisht për 42%. Të dhënat për numrin e të punësuarve në vitin 2025 ende nuk janë të disponueshme për publikun.

### Pasqyrë e numrit të të punësuarve në NP Rrugët Shtetërore

VITI	2020	2021	2022	2023	2024
NUMRI I TË PUNËSUARVE	366	367	356	352	501

Në vendimin për këtë prokurim publik të Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore thuhet se bëhet fjalë për realizimin e projektit më të madh strategjik në vend dhe se Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore ka nevojë për asistencë teknike për zbatimin e marrëveshjes për ndërtim me realizuesin “Behtel dhe Enka”, partneri strategjik dhe me mbikëqyrjen profesionale për zbatimin e projektit. Ekipi i ekspertëve teknikë duhet të ndihmojë Ndërmarrjen Publike për Rrugët Shtetërore për zbatimin e punimeve infrastrukturore përgjatë Korridoreve VIII dhe X-d dhe të kontribuojë në rritjen e kapacitetit të punonjësve të Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore për zhvillimin, vlerësimin, zbatimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e marrëveshjeve të mëdha infrastrukturore.

Prej pjesëmarrësve në tender është kërkuar kushti për të ardhura minimale vjetore prej 1,600,000 euro/në vit ose 98,552,480 denarë/në vit, në secilin prej 3 (tre) viteve të fundit (për vitet 2022, 2023 dhe 2024). Ndërkaq, sa i përket aftësisë teknike ose profesionale të operatorit ekonomik, është kërkuar një listë e livrimeve kryesore të mallrave ose shërbimeve të kryera me vlerat, datat, blerësit (autoritetet kontraktuese ose operatorët ekonomikë), me dhënie të vërtetimit për livrimet e realizuara ose shërbimet e kryera:

- Të paktën 1 (një) shërbim të kryer në 10 (dhjetë) vitet e fundit (përlogaritur nga data e shpalljes së tenderit) për Asistencë Teknike për investuesin (Klientin) në menaxhimin me ndonjë projekt për ndërtimin të autostradës/aksit të ndonjë autostrade në Ballkanin Perëndimor (për vende të Ballkanit Perëndimor, do të merren në konsideratë: Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia), me një vlerë të marrëveshjes për asistencë teknike prej të paktën 2 milionë euro (pa TVSH).
- Në rast se shërbimi është kryer nga një Grup i Ofertuesve – Sipërmarrje e Përbashkët, operatori ekonomik duhet të ketë pjesëmarrje prej të paktën 50% të vlerës së marrëveshjes për shërbimin. Shënim: Për të siguruar një nivel më i lartë konkurrence, kërkohen shërbime të kryera në 10 (dhjetë) vitet e fundit.

Në procedurën e tenderit është parashtruar vetëm një ofertë, nga Shoqëria Tregtare për Shërbime Inxhinierike dhe Konsulence SAFEGE Shkup, si udhëheqës i grupit të ofertuesve, të bashkuar me “Suez Consulting (SAFEGE)” Francë dhe SAFEGE SHPK Beograd. SAFEGE Shkup, pa këtë bashkim nuk do t'i përmbushte kushtet e tenderit. Pra, në periudhën 2022-2024, SAFEGE Shkup kishte të ardhura vjetore prej 7 deri në 9.7 milionë denarë, ose për 10 deri 14 herë më pak se kushti i përcaktuar për të ardhurat vjetore prej 98.6 milionë denarë.

SAFEGE Shkup është themeluar në vitin 2010 dhe gjatë këtyre 3 viteve të fundit ka dy të punësuar. Sipas të dhënave të disponueshme për publikun, “SUEZ Consulting” nga Franca është një kompani konsulence- inxhinierike, e cila i ndihmon qeveritë, komunitat, klientët industrialë dhe institucionet ndërkombëtare të planifikojnë, hartojnë dhe zbatojnë projekte që kanë të bëjnë me eko-tranzicionet, adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e qëndrueshëm afatgjatë të burimeve natyrore. SAFEGE nga Beogradi është një firmë inxhinierike dhe konsulence e themeluar në vitin 2007.

Sa i përket ofertës së parashtruar, është me rëndësi të theksohet që asnjë nga ekspertët e ofruar nuk është i punësuar në SAFEGE Shkup, por të gjithë kanë lidhur marrëveshje për bashkëpunim afarist dhe teknik me kompaninë e Shkupit.

Duke e pasur parasysh se tenderi përbëhet nga 13 pika ekspertësh, është vërtet e habitshme se si vlera e ofertës së ofertuesit të vetëm është pothuajse identike me vlerën e paraparë për tenderin. Konkretisht, në Vendimin për Prokurim Publik, i cili është dokument i brendshëm, thuhet se për këtë dedikim janë siguruar 236,000,000 denarë. Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore, në shpalljen për prokurimin publik nuk e ka deklaruar vlerën e parashikuar për tenderin. Oferta e fituar nga SAFEGE ka qenë me shumën 235,955,514 denarë, përkatësisht vetëm 44,486 denarë më pak se vlera e paraparë, që është një dallim prej vetëm 0,02%.

## Honorarë të lartë për ekipin e ekspertëve

Vlerat e honorarëve të ekipit të angazhuar maqedonas-serb lëvizin mes shumave 13,000 dhe 23,000 euro në muaj, për një ekspert. Megjithatë, pjesa më e madhe e ekspertëve do të jenë të angazhuar për 50 % të kohës së tyre, ndërsa një pjesë prej tyre edhe për më pak.

Për 4 vite angazhim, udhëheqësi i ekipit do të fitojë 550,000 euro. Tetë ekspertë do të fitojnë kompensim, vlera e të cilit lëviz mes shumave 272,000 dhe 500,000 euro, individualisht për secilin, ndërsa katër prej tyre janë me marrëveshje për vlerë më të vogël – mes 38,000 dhe 156,000 euro.

### Shpenzimet në nivel të ekspertëve

EMRI I POZICIONIT	EMRI I EKSPERTIT	ÇMIMI MUJOR NË EURO	NUMRI I MUAJVE	ÇMIMI TOTAL NË EURO
A1- UDHËHEQËS EKIPI/LIDER I EKIPIT	Dragan Mihajloviç	22,919	24	550,053
A2- EKSPERT PËR INFRASTRUKTURË TRANSPORTI	Sasha Zhivadinoviq	16,933	24	406,380
A3- EKSPERT PËR INFRASTRUKTURË TRANSPORTI	Milutin Shtërbiç	18,237	24	437,694
A4- EKSPERT PËR ÇËSHTJE FINANCIARE DHE TEKNIKE - KËRKESA PËR DËMSPËRBLIM	Branko Markoviq	20,843	24	500,228
A5- EKSPERT PËR ÇËSHTJET KONTRAKTUALE DHE DOKUMENTACION	Sllavoljub Tubiq	20,208	18	363,742
A6- EKSPERT I PROJEKTIMIT TË RRUGËVE	Riste Ristovski	15,156	18	272,808
A7- EKSPERT PËR OBJEKTE DHE STRUKTURA	Liljana Bjelogërlliq Çaliq	17,682	18	318,279
A8- EKSPERT PËR GJEOTEKNIKË/MATERIALE	Dushko Spirovski	15,156	18	272,802
A9- EKSPERT PËR INSTALACIONE ELEKTRIKE	Goran Hanxhiski	12,788	3	38,364
A10- EKSPERT PËR INSTALIME MEKANIKE	Vlladimir Boshnjakovski	12,788	3	38,364
A11- EKSPERT I MBROJTJES SË MJEDISIT JETËSOR	Sashka Bogdanova Ajceva	15,629	24	375,104
A12- EKSPERT I SHPRONËSIMIT	Emilija Gjorgiçkova	14,209	11	156,294
A13- EKSPERT PËR KOMUNIKACION RRUGOR DHE SIGURI RRUGORE	Filip Trajkoviq	17,760	6	106,563
	<b>TOTALI</b>			<b>3,836,675</b>

Nga ekspertët e punësuar, 6 janë nga Republika e Serbisë (udhëheqësi i ekipit Dragan Mihajloviç, eksperti për infrastrukturë të transportit Millutin Shtërbiç, eksperti i çështjeve financiare dhe teknike – kërkesa për dëmshpërblime Branko Markoviq, eksperti i çështjeve kontraktuale dhe dokumentacionit Sllavoljub Tubiq, ekspertja për objekte dhe struktura Liljana Bjelogërlliq Çaliq dhe eksperti për komunikacion rrugor dhe siguri rrugore Filip Trajkoviq), kurse 7 nga Maqedonia

(ekspert për infrastrukturë të transportit Sasha Zhivadinoviq, eksperti i projektimit të rrugëve Riste Ristovski, eksperti për gjeoteknikë/materiale Dushko Spirovski, eksperti për instalacione elektrike Goran Hanxhiski, eksperti për instalime mekanike Vlladimir Boshnjakovski, ekspertja e mbrojtjes së mjedisit jetësor Sashka Bogdanova Ajceva dhe ekspertja e shpronësimit Emilija Gjorgiçkova). Sipas dokumentacionit të tenderit dhe marrëveshjes së nënshkruar, dy nga ekspertët e huaj, eksperti për çështje financiare dhe teknike - kërkesa për dëmshpërblime dhe eksperti për çështje kontraktuale dhe dokumentacion, janë të detyruar të ofrojnë të paktën 20% të shërbimeve nga Shkupi, ndërsa për pjesën tjetër të ekspertëve, kjo përqindje është për 95% të kohës së angazhimit.

Edhe pse është e zakonshme që në këtë lloj të marrëveshjeve të mos ketë futje në detaje rreth kushteve operative për punën e konsulentëve, në këtë rast, në marrëveshjen saktësisht janë cekur mjetet motorike që konsulenti duhet t'i sigurojë, madhësinë e hapësirës së zyrës, si dhe përkrahjen administrative dhe teknike. Më konkretisht thuhet: "Konsulenti, për personelin e vet do të sigurojë dy mjete motorike të reja për terren (4x4, 5 vende dhe të paktën 110kW) si dhe një zyrë në Shkup (të paktën 150 m<sup>2</sup>) të pajisur në mënyrë adekuate me mobilje për zyrë dhe pajisje për mbarëvajtjen e punës. Shpenzimet për mirëmbajtjen e mjeteve motorike dhe zyrës do të mbulohen nga Konsulenti. Të gjitha shpenzimet për prokurimin, regjistrimin, sigurimin (mjetete motorike duhet të kenë "kasko" siguracion, në të njëjtën kohë edhe pasagjerët duhet të jenë të siguar në rast të çfarëdo aksidenti), karburantin, servisimin, riparimet, mirëmbajtjen dhe kostot e tjera për të gjithë kohëzgjatjen e shërbimeve do të mbulohen nga Konsulenti. Pronari i mjeteve motorike të terrenit është Konsulenti. Konsulenti gjithashtu do të sigurojë edhe mbështetje të përshtatshme administrative dhe teknike që do të përfshijë korrespondencën dhe komunikimin, përgatitjen e raporteve, ndihmën sekretariale/administrative, përkthimin e dokumenteve, si dhe me staf tjetër ndihmë, etj."

Përfshirja e kërkesave të detajuara për mjetet motorike, hapësirën e zyrës dhe mbështetjen administrative, megjithëse legjitime, nuk e ndryshon esencën që kostoja kryesore në këtë marrëveshje janë honorarët e ekspertëve. Shpenzimet operative janë dytësore krahasuar me vlerën totale të marrëveshjes dhe nuk mund ta justifikojnë lartësinë e atyre honorarëve.

**Në ekipin e ekspertëve është edhe një person i angazhuar në njësinë e projektit për implementim të projekteve të Bankës Botërore, e formuar në Ministrinë e Transportit. Kompenzimi mujor i saj, i paguar edhe pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje për prokurim publik, përkatësisht edhe në muajin janar edhe në muajin shkurt, sipas të dhënave në 'Otvoreni finansii' (Financa të hapura) është 1,600 euro bruto (99,000 denarë). Në këtë rast, e kontestueshme është çështja se si Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore vlerëson një personel të njëjtë dhjetëfish më tepër, përkatësisht me 15,600 euro në muaj, por edhe si mund dy institucione shtetërore të angazhojnë personel të njëjtë.**

NP për Rrugët Shtetërore, për këta ekspertë do të paguajë 950,000 euro në vit, që është në nivelin e pagës mesatare dhe shtojcave të rrogës (neto) për 92 punonjës. Konkretisht, kostoja mesatare mujore për pagat neto të punonjësve në Rrugët Shtetërore është 862 euro në muaj.

Kjo barrë e madhe financiare ngre pyetjen nëse fondet publike po përdoren në mënyrë racionale, veçanërisht në kushtet kur numri i të punësuarve në kompani është rritur për 149 persona (42%), gjë që duhet ta ketë rritur kapacitetin e brendshëm për të menaxhuar me këtë projekt.

Në të njëjtën kohë, vlerat e honorarëve të ekspertëve të angazhuar rishtazi janë disa herë më të larta nga kompensimi që NP për Rrugët Shtetërore e paguan për shërbime për konsulentë me profesorët në Fakultetin e Inxhinierisë Civile - rreth 1,300 euro bruto në muaj. Çdo vit, për disa vite me radhë, NP për Rrugët Shtetërore ka nënshkruar kontrata me Fakultetin e Inxhinierisë Civile - Shkup për analiza dhe mendime konsultative të ekspertëve gjatë projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve shtetërore në Republikën e Maqedonisë, konsultime ekspertësh gjatë punës përgatitore për përgatitjen e dokumentacionit teknik, konsultime ekspertësh gjatë përgatitjes së dokumentacionit teknik, revidim të dokumentacionit teknik të përgatitur, dhënie të mendimeve dhe analiza konsultative të ekspertëve gjatë ndërtimit, përmirësimit - rehabilitimit të strukturave të akseve rrugore dhe objekteve në to dhe, nëse është e nevojshme, për të kryer teste kontrolluese gjeomekanike, asfalti dhe betoni. **NP “Rrugët Shtetërore” aktualisht ka një marrëveshje me Fakultetin e Inxhinierisë Civile, të nënshkruar në bazë të një procedure prokurimi publik me numër 03438/2025 dhe me vlerë prej 70,797,168 denarë, ose rreth 1.2 milion euro. Megjithatë, nga Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore thonë që shërbimet nga marrëveshja me Fakultetin e Inxhinierisë Civile nuk përdoren për ndërtimin e akseve të autostradës në korridorin VIII dhe korridorin X-d.**

Të gjithë faktorët e mësipërm veç më tepër e imponojnë pyetjen se si nga NP për Rrugët Shtetërore e kanë përcaktuar vlerën e parashikuar për tenderin. Neni 39 i Ligjit për Prokurime Publike i transponon rregullat për vlerësimin e vlerës së prokurimeve. Paragrafi (1) inkorporon një rregull të përgjithshëm se si vlerësohet vlera e një marrëveshjeje për prokurim publik. Ajo vlerësohet duke marrë parasysh shumën totale të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes, duke i marrë parasysh kushtet e tregut. Kjo, sipas Udhëzuesit Praktik për Prokurimet Publike, autorët e të cilit janë përfaqësues të Byrosë së Prokurimeve Publike, nënkupton se gjatë vlerësimit të vlerës, autoriteti kontraktues duhet paraprakisht ta hulumtojë tregun dhe të ketë një ide të caktuar se cilat janë kushtet e tregut për lëndën specifike të prokurimit. Ligji nuk përmban më shumë detaje se si të zhvillohet hulumtimi i tregut dhe si të dokumentohet ky proces, por gjithsesi që rekomandohet të ketë ndonjë gjurmë se si është arritur në vlerën specifike të përllogaritur. Duke e pasur parasysh këtë, nga NP për Rrugët Shtetërore kemi kërkuar informacion lidhur me përllogaritjen dhe mënyrën se si është përcaktuar vlera e parashikuar për tenderin. Kjo është përgjigja që e fituam: “Përllogaritjet dhe metoda e përcaktimit të vlerës së parashikuar për prokurimin publik bazohen në Marrëveshje të mëparshme të ngjashme që janë nënshkruar ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), si dhe Marrëveshje të ngjashme të nënshkruara me Bankën Botërore. Në këto marrëveshje është paraparë një lloj i ngjashëm ekspertësh dhe bazuar në ato çmime, është formuar vlera e parashikuar për prokurimin publik për Asistencë Teknike për Korridorin 8 dhe Korridorin 10-d.

Kjo përgjigje e përgjithësuar nga NPRRSH nuk është në përputhje me të dhënat e disponueshme për publikun lidhur me shumën e honorarëve të njësisë për implementimin e projekteve të Bankës Botërore të formuar në Ministrinë e Transportit.

Është e rëndësishme të theksohet se në marrëveshjen është cekur që periudha për zbatimin e kontratës do të jetë 48 muaj. Ky afat kohor mund të shkurtohet nëse punimet e ndërtimit përfundojnë për më pak se 48 muaj ose të zgjatet me kërkesë të Investuesit.

**Duke pasur parasysh barrën e lartë financiare, ky model i angazhimit të ekspertëve të jashtëm nuk mund të konsiderohet i zakonshëm, ekonomikisht i arsyeshëm ose transparent, pa arsyetim shtesë dhe prova të forta për vlerë të jashtëzakonshme të shtuar.**

## Kronologjia e tenderit për asistencë teknike për ndërtimin e akseve të autostradave në Korridorin VIII dhe Korridorin X-d

Para nënshkrimit të kësaj marrëveshjes për prokurim publik janë zhvilluar 2 procedura tenderimi, dhe nga publikimi i shpalljes së parë deri në nënshkrimin e marrëveshjes kanë kaluar plot 11 muaj.

**17.01.2023:** Kompania e publikon Planin për Prokurime Publike për vitin 2023 dhe në të parasheh që prokurimi me lëndën asistencë teknike për ndërtimin e akseve të autostradave në Korridorin VIII dhe Korridorin X-d do të fillojë në janar. Prokurimi i planifikuar nuk po realizohet.

**26.01.2024:** Prokurimi nuk është parashikuar në Planin për Prokurime Publike për vitin 2024.

**05.08.2024:** Me ndryshime në Planin për Prokurime Publike për vitin 2024 instalohet një procedurë për prokurim publik - analiza dhe mendime konsultative profesionale për ndërtimin e akseve të autostradës në Korridorin VIII dhe Korridorin X-d.

**08.11.2024:** Plani për Prokurime Publike ndryshohet dhe titulli i tenderit ndryshohet dhe në vend të – “Analiza dhe mendime konsultative profesionale për ndërtimin e akseve të autostradës në Korridorin VIII dhe Korridorin X-d”, tenderi emërtohet “Asistencë teknike për ndërtimin e akseve të autostradave në Korridorin VIII dhe Korridorin X-d”.

**03.12.2024** Publikohet shpallje për prokurimin me numrin rendor 20860/2024

**13.03.2025:** Procedura anulohet me arsyetimin se nuk është paraqitur asnjë ofertë ose asnjë ofertë e pranueshme.

**16.06.2025** Shpallet procedurë e re për prokurim publik me numrin rendor 10862/2025. Dokumentacioni i tenderit dhe programi i projektit janë ndryshuar vetëm në pjesën e llojit të ekspertëve dhe numrit të tyre. Në tenderin e mëparshëm, kërkohet personel thelbësor ekspertize (13 persona) dhe personel jo-thelbësor ekspertize (2 persona). Në tenderin aktual, kërkohen vetëm ekspertët thelbësorë (13 persona) me të njëjtin përshkrim të angazhimit dhe kualifikimeve të tyre.

**24.07.2025:** Hapja e ofertave. Është dorëzuar vetëm një ofertë, nga Kompania Tregtare për Shërbime Inxhinierike dhe Konsulencë SAFEGE Shkup, si udhëheqës i një grupi ofertuesish të bashkuar me Suez Konstatting (SAFEGE) Francë dhe SAFEGE SHPK Beograd. Oferta është financiarisht pothuaj identike me vlerën e parashikuar të marrëveshjes.

**03.11.2025** Kontrata është nënshkruar. Nuk ka arsye objektive pse ishte e nevojshme të pritet 70 ditë për të nënshkruar marrëveshjen.



Kingdom of the Netherlands

Hulumtimi është zhvilluar në kuadër të projektit “Mbikëqyrje publike mbi prokurimet publike”, me asistencë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, i implementuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën nga 1 tetori 2025 deri më 30 shtator 2027.